



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 60 regjistër (JR)  
Datë 22.11.2019

Nr. 21 i vendimit  
Datë 15.07.2021

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.07.2021, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Hysni Vata, prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 e 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; si dhe Kodi i Procedurës Civile.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hysni Vata ka ushtruar detyrën e prokurorit dhe drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Hysni Vata (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilave ka rezultuar:

- 1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konstatuar se:

- i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii) ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv) ka kryer deklarim të rremë;
- v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

- 1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup>, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata.*

- 1.3 KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr.

<sup>1</sup> ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.02.2018, ka përcjellë pranë Komisionit raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Hysni Vata.

<sup>2</sup> DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin me nr. {\*\*\*} prot., datë {\*\*\*}.2018, për subjektin e rivlerësimit Hysni Vata, të deklasifikuar pjesërisht.

84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup>.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 195, datë 09.09.2019.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Komisioni, me vendimin nr. 195, datë 09.09.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hysni Vata, me detyrën e prokurorit dhe drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

### **3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:**

*Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme dhe ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet dhe njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5, e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

### **3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:**

*Në lidhje me kontrollin e figurës, në mungesë të provueshmërisë së plotë të dyshimeve të arsyeshme të ngritura, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas shkronjës “b”, të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi, për sa i përket rivlerësimit të figurës, trupi gjyqësor nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet dhe elementet e administruara në nivel të dhënash dhe/ose dyshimesh të arsyeshme në dispozicion për të konkluduar ndryshe dhe, për rrjedhojë, e konsideron subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

### **3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:**

*Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura, anomali dhe shkelje procedurale, të cilat sipas parashikimit të pikës 4, të nenit E, nuk mund të korrigjohen nëpërmjet programit njëvjeçar të trajnimit. Si rrjedhim, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas shkronjës “c”, të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 4 e nenit 61 e ligjit nr. 84/2016.*

### **3.4 Në vlerësimin tërësor të çështjes:**

*Nga vlerësimi tërësor dhe, kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 e ligjit nr. 84/2016.*

---

<sup>3</sup> KLP-ja ka përcjellë në Komision raportin me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.03.2019, për subjektin e rivlerësimit Hysni Vata.

### III. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.10.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 195/1, datë 23.10.2019.
5. Në ankim dhe në parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore (në vijim “parashtrimet”), subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke pretenduar të vazhdojë hetimin administrativ të provave të paraqitura pranë Komisionit dhe në përfundim të vendosë për ndryshimin e vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
6. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 195, datë 09.09.2019, janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit si më poshtë.

#### *A. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit*

**6.1** Komisioni nuk përbën një gjykatë të pavarur e të paanshme, pasi e njëjta trupë gjykuese ka bërë edhe hetimin administrativ dhe ka marrë edhe vendimin për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke vepruar si një gjykatë e jashtëzakonshme, në kundërshtim me rregullat e procesit administrativ dhe ligjit nr. 84/2016.

**6.2** Rivlerësimi i aftësive profesionale është bërë nga Komisioni duke shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi janë përfshirë në vlerësim procedime penale, të cilat nuk kanë qenë brenda periudhës së rivlerësimit të përcaktuar nga ligji nr. 84/2016.

**6.3** Përfshirja e raportit pozitiv të KLP-së për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, është bërë nga ky i fundit vetëm formalisht, por në fakt i gjithë procesi dhe vendimmarrja ka qenë e paracaktuar, në shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

**6.4** Komisioni, në procedurën e rivlerësimit të subjektit, nuk ka respektuar disa nga parimet e sanksionuara nga Kodi i Procedurave Administrative, duke cenuar të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor.

**6.5** Standardi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme nuk është respektuar edhe për shkak të formimit akademik dhe eksperiencës profesionale të trupës gjykuese të Komisionit, e cila në këtë aspekt ka qenë në pamundësi objektive për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për shkak të mungesës së qasjes së anëtarëve të saj ndaj ligjit penal dhe atij procedural.

**6.6** Analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë mbi çmuarjen ligjore të provave, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si dhe duke evidentuar elemente të theksuara paragjykimi dhe të një vendimi të paracaktuar.

6.7 Dhënia e vendimit nga Komisioni, në shkelje flagrante të ligjit dhe provave, ka sjellë shkeljen e së drejtës së respektimit të jetës private, parashikuar në nenin 8, paragrafi 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

*B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

6.8 Vlerësimi i Komisionit është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur përmbushen në mënyrë kumulative deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, ndërsa Komisioni për kriterin e kontrollit të figurës e ka konsideruar subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

6.9 Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë që disponon, pasi vlera totale e të ardhurave familjare në vite është më shumë se trefishi i vlerës së pasurive.

6.10 Pasaktësia në deklarimin e vlerës së pasurisë apartament banimi në qytetin e Burrelit dhe mosdeklarimi i shkëmbimit të saj me një apartament tjetër në po të njëjtin qytet, ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së subjektit të rivlerësimit, pa pasur si qëllim manipulimin e vlerës së blerjes së kësaj pasurie, as të fshehjes dhe as të deklarimit të rremë të saj.

6.11 Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, pasuria apartament me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup> në Tiranë, është krijuar nga subjekti i rivlerësimit me burime krejtësisht të ligjshme financiare.

*C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës*

6.12 Barra e provës është ndryshuar nga Komisioni në mënyrë formale, për t’i pamundësuar subjektit të rivlerësimit realizimin e së drejtës së mbrojtjes, pasi në bazë të raportit mbi kontrollin e figurës, është paragjykuar i gjithë procesi i rivlerësimit ndaj tij, si dhe është paracaktuar vendimi përfundimtar.

*Ç. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

6.13 Komisioni ka shkelur parimin e gjësë së gjykuar dhe parimin e sigurisë juridike, pasi vendimet e marra nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë prokurorit, të cilat janë bërë pjesë e kontrollit të Komisionit, kanë qenë më parë pjesë e kontrollit periodik nga Prokuroria e Përgjithshme, KLP-ja, Ministria e Drejtësisë e gjykatat, duke u vlerësuar si vendimmarrje të rregullta e të bazuara në ligje.

6.14 Lidhur me fashikujt e procedimeve penale dhe mosfillimet e procedimeve penale, subjekti i rivlerësimit nuk është vënë asnjëherë në dijeni për mënyrën e përzgjedhjes së tyre, ndarjes, vlerësimit në kohë dhe rrethanave të paqarta të tërheqjes së tyre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër. Komisioni, këto dosje i ka bërë pjesë të hetimit administrativ, pasi ky i fundit kishte përfunduar, duke i përdorur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.

6.15 Çështjet penale nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} janë ende në procedurë gjykimi e, për pasojë, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk duhet të përfshiheshin nga Komisioni në vlerësimin e aftësive profesionale.

**6.16** Veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ka qenë në përputhje të plotë me ligjin.

**6.17** Në procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me masën e dënimit me burgim, ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**6.18** Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ka qenë plotësisht i arsyetuar dhe i bazuar në prova dhe në ligj.

**6.19** Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, është vlerësuar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, konform kërkesave të ligjit.

**6.20** Vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, është i arsyetuar, duke përfshirë të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e çështjes bazuar në prova dhe ligj.

**6.21** Vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është marrë mbi bazën e rrethanave dhe verifikimeve të plota, si administrimit të të gjitha provave.

**6.22** Vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është marrë mbi bazën e një arsytimi të plotë të rrethanave të ngjarjes, akteve shpresore të administruara në fashikull, ekspertimit mjeko-ligjor etj., duke qenë i bazuar në prova dhe ligj.

**6.23** Vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është marrë pas krijimit të bindjes së arsyeshme, të bazuar në prova, se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të regjistruar procedimin penal.

#### *D. Shkaqet e ankimit që lidhen me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*

**6.24** Në asnjë rresht të vendimit, Komisioni nuk ka arsyetuar se cila është ajo shkelje, e cila ngrihet në nivelin e dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por vetëm ka bërë citimin formal të dispozitës, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit.

**6.25** Shkaqet e vlerësuara nga Komisioni, nuk mund të shërbejnë si indikator për të dalë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, për arsyet si vijojnë.

a) Në asnjë rresht të vendimit të Komisionit nuk është arsyetuar se ku qëndrojnë shkeljet e etikës nga ana e subjektit të rivlerësimit.

b) Është vlerësuar se ka cenim të besimit të publikut edhe për procedime penale për të cilat është vendosur dërgimi për gjykim, ashtu edhe për ato për të cilat është kërkuar pushimi ose mosfillimi i procedimit penal.

c) Janë shfuqizuar vetëm dy dosje në nivel hierarkik, në një hark kohor prej 11 vjetësh dhe, bazuar në parimin e proporcionalitetit, ky fakt nuk mund të përbëjë shkak për të përligjur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

ç) Nuk ka pasur asnjë rast shfuqizimi vendimi, procedimi apo mosfillim procedimi, qoftë nga drejtuesit, qoftë nga gjykata, në bazë të ankimit të ndonjë prej palëve.

d) Gjykatat, si i vetmi organ që u është njohur tagri i dhënies së drejtësisë, e kanë gjetur vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit të bazuar në ligj e në prova.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### *A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit*

7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 195, datë 09.09.2019, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).

Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

8. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, pretendimi i tij që Kolegji të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike, gjendet i pabazuar, pasi rezulton se kjo e drejtë i është respektuar nga Komisioni në seancën dëgjimore dhe subjekti ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve gjatë zhvillimit të procesit në Komision.

9. Shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar edhe në Kolegj, nuk është i nevojshëm, pasi subjekti nuk ka paraqitur prova të reja me ankimin, por edhe për faktin se kërkitimi/argumenti që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë publike, për një vlerësim të drejtë të provave të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk parashikohet në kërkesat e pikës 1 të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, debati gjyqësor në seancë gjyqësore, me praninë e subjektit, u vlerësua nga trupi gjykues se është i panevojshëm, pasi: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e prova të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje, apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni. Hetimi gjyqësor ka qenë i rregullt, vendimmarrja e Komisionit ka qenë në përputhje të plotë me parimet e procesit të rregullt ligjor, duke i garantuar subjektit të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 dhe nuk ka shkaqe për pavlefshmëri të tij; c) nuk vlerësohet se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision.

Për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit.

##### *B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor*

10. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni nuk përbën një gjykatë të pavarur e të paanshme, pasi e njëjta trupë gjyquese ka bërë edhe hetimin administrativ dhe ka marrë edhe vendimin për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke vepruar si një gjykatë e jashtëzakonshme, në kundërshtim me rregullat e procesit administrativ dhe ligjit nr. 84/2016*, trupi gjyques vlerëson se Kolegji ka mbajtur një qëndrim të cilin e ka konsoliduar tashmë në praktikën e tij gjyqësore, sipas të cilit kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces i nisur kryesisht dhe në përputhje me kompetencën që atij ia njeht Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Ushtrimi i këtyre kompetencave nga një organ i vetëm është pranuar nga Komisioni i Venecias<sup>4</sup>, më tej është konsideruar në përputhje me parimet kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 dhe së fundmi është konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNJ”) në vendimin që i përket çështjes Xhoxhaj kundër Shqipërisë<sup>5</sup>, në të cilin kjo gjykatë është shprehur: *Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme, është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë. [...] Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.*

Në konkluzion, trupi gjyques vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk përbën një gjykatë të pavarur e të paanshme, pasi e njëjta trupë gjyquese ka bërë edhe hetimin administrativ dhe ka marrë edhe vendimin, është i pabazuar.

11. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *rivlerësimi i aftësive profesionale është bërë nga Komisioni duke shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi janë përfshirë në vlerësim procedime penale të cilat nuk kanë qenë brenda periudhës së vlerësimit të përcaktuar nga ligji nr. 84/2016*, trupi gjyques vëren se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni për procedimet penale nr. {\*\*\*}, nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} është jashtë periudhës së vlerësimit të përcaktuar nga neni 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kuptim të të cilit periudha e vlerësimit të aftësive profesionale është nga data 08.10.2013 - 08.10.2016.

---

<sup>4</sup> Komisioni i Venecias, në Opinionin CDL-AD (2016)036 për ligjin nr. 84/2016, është shprehur: “Duhet të mbahet parasysh edhe fakti se neni Ç, paragrafi 4 i Aneksit të Kushtetutës i jep shprehimisht Komisionit të Pavarur dhe Kolegjit të Apelimit kompetenca të gjera për t’i investiguar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, organet zyrtare duhet të bashkëpunojnë dhe të venë në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelimit, duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në databazën e tyre. Po ashtu, neni 45 i Ligjit të Vettingut i lejon anëtarët e Komisionit të Pavarur dhe të Kolegjit të Apelimit të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes. Neni 57(4) parashtron parimin se në procesin vendimmarrës të Komisionit të Pavarur, përfundimet nxirren nga trupi gjyques”.

<sup>5</sup><https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22%3A%22document%22%2C%22itemid%22%3A%22001-208053%22%7D>, paragrafët 307 dhe 308.



12. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni në vendim, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ka marrë në shqyrtim dosjet e procedimeve penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit [dhe drejtuesit] pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, përkatësisht:

o Procedimin penal nr. {\*\*\*}, për të cilin Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Për sa më lart, lidhet direkt me mangësi të kryera në aktivitetin profesional të kryer nga subjekti jo vetëm si drejtues, por edhe si urdhërues dhe përmbushës i disa veprimeve hetimore në këtë dosje, ndonëse për këtë detyrë, zyrtarisht dhe formalisht, ishte deleguar prokurori R. T. Kjo qasje proaktive e z. Hysni Vata, në kryerjen e disa veprimeve hetimore personalisht, nga njëra anë rezulton në kapërcim të kompetencave të drejtuesit, sipas të cilave ai vetëm duhej të verifikonte aktin përfundimtar të hetimeve duke e miratuar apo shfuqizuar atë. Ndërsa, nga ana tjetër konfirmon (edhe pse në mënyrë të tërthortë) dyshimet e ngritura nga informacione të klasifikuara, lidhur me veprimtarinë e subjektit në këtë procedim<sup>6</sup>.*

o Procedimin penal nr. {\*\*\*}, për të cilin Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se vendimi i pushimit në fjalë rezulton i pabazuar në fakte dhe i motivuar në mënyrë sipërfaqësore dhe i paargumentuar mjaftueshëm. Procedimi, i konkluduar me këtë vendim pushimi jobindës, evidenton një sërë problematikash, si: mangësi hetimore; analizë joobjektive mbi faktet e dinamikës së aksidentit dhe lidhjes së tij shkak-pasojë me pasigurinë e frontit të punës në galerinë nr. {\*\*\*}; arsyetim të dobët dhe të pambështetur në prova; dyshime për favorizim të personave nën hetim, duke konfirmuar në këtë mënyrë edhe dyshimet e ngritura nga burimet konfidenciale dhe nga informacionet e klasifikuara, me pasojë cenimin e besimit të publikut te figura e prokurorit/magjistratit<sup>7</sup>.*

o Procedimin penal nr. {\*\*\*} për të cilin Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Edhe në këtë rast, Komisioni u referohet konkluzioneve dhe arsyetimeve të përshkruara më lart, në lidhje me çështjen e mësipërme (procedimin penal nr. {\*\*\*} i vitit {\*\*\*}), për sa u përket mangësive profesionale të subjektit, veprimeve dhe mosveprimeve të tij, në këtë rast të evidentuara edhe nga dy gjykata. Bazuar në sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se pikërisht për këto çështje, trupi gjykues ka parë informacione konfidenciale pranë organeve ligjzbatuese që i referohen favorizimit që subjekti i rivlerësimit ka kryer për personat nën hetim, trupi gjykues çmon se kjo lloj qasjeje në hetime, mangësitë profesionale hetimore të konstatuara, si dhe vendimmarrjet nga ana e subjektit, kanë çuar në cenimin e besimit të publikut ndaj figurës së prokurorit<sup>8</sup>.*

Procedimet penale nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} i janë përcjellë Komisionit si një gjetje nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, e cila konsiston në analizën dhe shqyrtimin e aftësive profesionale të subjektit, në bazë të nenit B të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 10 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me disa procedime penale të hetuara prej tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

13. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me arsyetimin e bërë në vendimin e Komisionit dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 84/2016, në pikën 3 të nenit 41 ka përcaktuar periudhën e rivlerësimit për aftësitë profesionale, e cila do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit. Për këtë arsye, raporti i KLP-së për analizimin e aftësive profesionale shtrihet në periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016.

<sup>6</sup> Paragrafi 111 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

<sup>7</sup> Paragrafi 134 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

<sup>8</sup> Paragrafi 141 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

Në pikën 4, neni 41 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit të subjektit përkatës të rivlerësimit.

Edhe Gjykata Kushtetuese, në arsyetimin e vendimit nr. 2/2017, në interpretimin pajtues të ligjit nr. 84/2016, është shprehur për lejimin e shtrirjes së afatit të vlerësimit të aftësive profesionale për periudhën nga 1 janari 2006 e në vazhdim deri në vitin 2016 dhe jo për periudha të mëvonshme<sup>9</sup>. Në verifikimin e zbatimit të kuadrit ligjor të sipërcituar në rastin konkret, rezultoi se Komisioni i ka marrë në shqyrtim procedimet penale nr. {\*\*\*}, nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} në bazë të informacionit që ka disponuar për etikën dhe aftësitë profesionale dhe në bazë të gjetjes së përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar, duke plotësuar kushtet e nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 për shtrirjen e periudhës së vlerësimit për aftësitë profesionale, për një periudhë më të gjatë kohore se sa tri vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në këto kushte, shkak i ankimit i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

14. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *përfshirja e raportit pozitiv të KLP-së për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, është bërë nga ky i fundit vetëm formalisht, pasi në fakt i gjithë procesi dhe vendimmarrja ka qenë e paracaktuar, në shkëlqje të parimit të gjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, ka arsyetuar: *Në përfundim të analizës së mësipërme, KLP-ja, duke marrë parasysh edhe vlerësimin e subjektit “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka konkluduar se nuk janë konstatuar shkëlqje të rënda procedurale ose të etikës, apo paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Vata. [...] Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, duke pasur parasysh faktin që janë paraqitur një numër i konsiderueshëm denoncimesh, ka kryer një rivlerësim tërësor të kriterit profesional, nëpërmjet një kombinimi të balancuar midis raportit të sipërpërmendur dhe vlerësimit të dosjeve dhe problematikave profesionale të denoncuar, ose të administruara në sajë të informacioneve të rezervuara dhe/ose të klasifikuara, si më lart<sup>10</sup>.*

Referuar vijimësisë së përmbajtjes së vendimit të Komisionit, rezultoi se për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përtej kontrollit të ushtruar mbi çështjet e përzgjedhura në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është kryer kontroll mbi veprimtarinë e zhvilluar prej tij në rrethet ku ka ushtruar detyrën e prokurorit, përkatësisht në Dibër, për të cilën në Komision ka pasur denoncime nga publiku dhe nga burime të tjera, në zbatim të nenit 43, pika 4 e

---

<sup>9</sup> Konkretisht, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar: “Gjykata vlerëson se, si rregull, bazuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vjetët e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4, ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë gjithashtu nga organet e reja kushtetuese të rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit. Duke zbatuar edhe në këtë rast interpretimin pajtues të normës, gjykata vlerëson se kjo është mënyra se si duhet të interpretohet pika 4 e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 nën dritën e standardeve kushtetuese dhe se një interpretim i ndryshëm i saj mund të bëhet shkak edhe për trajtimin e pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit”.

<sup>10</sup> Paragrafët 93-94 të vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

ligjit nr. 84/2016<sup>11</sup>, si dhe gjetje të përcjellë në Komision nga vëzhguesi ndërkombëtar në zbatim të nenit 49, pika 10 e po këtij ligji.

15. Procesi i rivlerësimit është një proces i parashikuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, i miratuar dhe i gjithëpranuar si një proces i jashtëzakonshëm kontrolli për subjektet e rivlerësimit, i cili kryhet në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës për rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Asnjë parashikim kushtetues apo ligjor nuk kushtëzon ushtrimin e kontrollit prej organeve të rivlerësimit apo qëndrimin e vendimmarrjen e tyre brenda fushës së tyre të veprimit, nga raportet që ndërtohen nga institucionet brenda sistemit të drejtësisë, në funksion të këtij procesi. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2/2017, në të cilin është mbajtur qëndrimi që Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit, ka arsyetuar: *31. Edhe pse në këtë rast Kushtetuta nuk ka parashikuar specifikisht organin që do të kryejë kontrollin paraprak të deklaratës së dorëzuar nga gjyqtarët dhe prokurorët, me përjashtim të Shkollës së Magjistraturës, e cila është ngarkuar me kryerjen e testimi për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, sipas nenit 10/3 të ligjit organet e vlerësimit të aftësive profesionale janë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që funksionon sipas ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme ose institucionet që bëjnë vlerësimin profesional sipas ligjit. 32. Gjykata vlerëson se këto organe nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore në mënyrë të shkëputur nga veprimtaria e organeve të rivlerësimit, KPK-ja dhe KA-ja, por nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre të fundit. Për shkak të misionit që ato kanë dhe funksionit që kryejnë, qëllimi i përfshirjes së tyre në këtë proces është që të ndihmojnë organet kushtetuese në ushtrimin e kompetencave kushtetuese. Duke bërë një interpretim të tillë të këtyre dispozitave ligjore konkludohet se edhe në këtë rast ligji nuk e ka zhvendosur kontrollin dhe hetimin tek organet ekzistuese dhe ato nuk kanë marrë dhe as nuk ushtrojnë kompetencat që u njihen organeve të reja kushtetuese.*

Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vlerësimi i aftësive profesionale është kryer nga Komisioni në përputhje me dispozitat ligjore dhe interpretimin pajtues të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbetet një pretendim i pabazuar.

16. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni, në procedurën e rivlerësimit të subjektit, nuk ka respektuar disa nga parimet e sanksionuara nga Kodi i Procedurave Administrative, duke cenuar të drejtën e subjektit për një proces të rregullt ligjor, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në ankim, ka parashtruar se Komisioni nuk ka respektuar: parimin e ligjshmërisë, pasi atij nuk i janë bërë të ditura të drejtat në kuadër të procesit të rivlerësimit; parimin e transparencës pasi Komisioni nuk u është përgjigjur kërkesave të subjektit të rivlerësimit; parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, barazisë dhe mosdiskriminimit, pasi komunikimi me subjektin ka qenë i cunguar dhe diskriminues në raport me subjektet e tjera, subjektit i është mohuar e drejta për t’u njohur me dosjen dhe gjithashtu, në lidhje me denoncimet atij nuk i janë bërë me dije veprimet e ndërmarra nga Komisioni sa u përket verifikimeve mbi denoncuesit.

---

<sup>11</sup> Neni 43, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “4. Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale”.

17. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga tërësia e dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se me vendimin nr. 1, datë 20.03.2018, trupi gjykues i Komisionit ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit dhe ka vendosur fillimin e hetimit administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë zhvillimit të procesit të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit paraqitjen e shpjegimeve dhe provave, nëpërmjet dërgimit të pyetësorëve, në funksion të rrethanave dhe nevojave të këtij hetimi. Me vendimin nr. 2, datë 01.07.2019, Komisioni ka vendosur përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht, kontrollin e pasurisë, të figurës dhe atë profesional.

Në datën 03.07.2019, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 18.06.2019; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni për çdo rezultat është shprehur qartë se në cilat prova është bazuar, duke i cituar ato, përfshirë edhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit deri në këtë fazë të hetimit. Për çdo gjetje, rezultatet e hetimit përmbajnë analizën e provave dhe analizën financiare, kur është rasti.

Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me dosjen dhe ka marrë kopje të saj<sup>12</sup>, ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e veta në Komision, në datën 18.07.2019, së bashku me një kërkesë për të dëgjuar disa persona si dëshmitarë. Trupi gjykues i Komisionit, pasi e shqyrtoi dhe e vlerësoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provës me dëshmitarë, ka vendosur që të mos e pranojë atë, në bazë të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ashtu siç është pasqyruar edhe në arsyetimin e vendimit të marrë prej Komisionit<sup>13</sup>, pasi pothuajse të gjithë personat e kërkuar për t'u dëgjuar i kishin shprehur qëndrimet dhe dijenitë e tyre në lidhje me faktet për t'u provuar dhe, edhe sikur dëshmitarët të konfirmonin versionin e fakteve të shpjeguara më herët nga subjekti, mbi punësimin dhe fitimet e vëllait të tij, z. M. V., në Greqi, nuk do të mjaftonte prova me dëshmitarë për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të vëllait në cilësinë e huadhënësit, i cili, ashtu siç ka deklaruar vetë subjekti, nuk rezultonte të kishte jetuar asokohe me leje qëndrimi në shtetin grek dhe, rrjedhimisht, nuk kishte punuar i regjistruar që të kishte kryer pagesat e detyrimeve tatimore dhe kontributeve për sigurimet shoqërore.

Me vendimin nr. 3, datë 19.07.2019, Komisioni ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, ka kërkuar shtyrjen e seancës për arsye shëndetësore, kërkesë e cila është pranuar nga Komisioni. Në datën 30.07.2019, Komisioni i ka njoftuar subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike, datën e re për seancën dëgjimore, të caktuar për më 04.09.2019, datë në të cilën ajo u zhvillua rregullisht, ku subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe u është përgjigjur pyetjeve të bëra nga Komisioni dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar. Në këtë seancë, subjekti ka deklaruar se ka marrë të gjitha dokumentet, pjesë përbërëse e dosjes së tij të rivlerësimit dhe nuk

---

<sup>12</sup> Deklaratë, datë 05.07.2019, e subjektit të rivlerësimit për njohjen me dosjen e rivlerësimit, si dhe inventari bashkëlidhur saj.

<sup>13</sup> Paragrafi 6 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

ka kundërshtuar elemente procedurale të procedurës së hetimit të zhvilluar ndaj tij, apo elemente procedurale të lidhura me zhvillimin e seancës dëgjimore.

Nga sa u analizua më sipër, trupi gjykues vlerëson se, në kundërshtim me sa pretendon, subjektit të rivlerësimit i janë bërë me dije të drejta në kuadër të procesit të rivlerësimit, të cilat ai i ka ushtruar, duke paraqitur prova dhe duke kërkuar marrjen e provave me dëshmitarë. Komisioni ka argumentuar dhe arsyetuar edhe në vendimin përfundimtar refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit në lidhje me thirrjen e dëshmitarëve.

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk i është bërë e ditur e drejta për t'u njohur me dosjen, duke e lidhur këtë pretendim me përmendjen në vendimin e Komisionit të dy kallëzimeve penale për të cilat është vendosur mosfillim i procedimit penal, por që ai nuk është njohur asnjëherë me këto vendime. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se kallëzimet penale ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat janë trajtuar në vendim, në paragrafin e titulluar "Të dhëna nga burimet arkivore", janë një përmbledhje e raportit për analizimin e aftësive profesionale të përcjellë nga KLP-ja në Komision, raport i cili është pranuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, jo vetëm si i njohur prej tij, por edhe i drejtë e korrekt. Nga verifikimi i hapave proceduralë të ndjekur nga Komisioni, siç u përshkruan në paragrafin 17 më sipër në këtë vendim, rezultoi e provuar se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.
19. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka respektuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, konstatohet se ky pretendim nuk lidhet me ndonjë shkelje konkrete që pretendohet të ketë ndodhur gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar në ankimin e tij asnjë problematikë apo rrethanë, e cila do të përlligjte shkeljen e parimeve të pretenduara prej tij.
20. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu, se në lidhje me denoncimet nga publiku, nuk i janë bërë me dije veprimet e ndërmarra nga Komisioni, në lidhje me verifikimet mbi denoncuesin, detyrim që sipas tij rrjedh nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit bazohet në një lexim dhe interpretim të gabuar të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij neni, informacioni i përcjellë nga publiku në denoncimin e fakteve duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit. Në përmbajtjen e këtij neni, nuk parashikohet në asnjë moment detyrimi i Komisionit për verifikimin e denoncuesit, por vetëm detyrimi i tij për verifikimin e fakteve që krijojnë bindjen mbi shkeljen e pretenduar. Veprimet për verifikimin e këtyre denoncimeve, Komisioni i ka shpjeguar në vendim, duke u shprehur: *Rezulton se pranë Komisionit, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Vata, janë paraqitur nga publiku, nëntë denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Çështjet në të cilat, pas analizimit të tyre, në saje të ankesave të paraqitura në disa nga denoncimet në fjalë, janë evidentuar problematika apo mangësi, do të trajtohen më poshtë. Në vijim të denoncimeve nga publiku dhe të informacioneve të tjera të marra nga Komisioni, nëpërmjet organeve ligjzbatuese, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa dosje hetimore dhe gjyqësore. Për një vlerësim më të plotë të kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit, janë studiuar aktet, vendimet ose materialet e dosjeve në fjalë, dhe nga analiza e të cilave ka rezultuar sa vijon.*

Në këto kushte, nga analiza e shqyrtimi i veprimtarisë procedurale të kryer nga Komisioni, trupi gjykues nuk gjeti elemente që do të mund të konsideroheshin se janë kryer në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, për pasojë arriti në konkluzionin se Komisioni ka respektuar gjatë procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të gjitha garancitë që ofrohen nga zbatimi i parimeve të pretenduara si të shkelura prej tij e që konsistojnë në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”). Për rrjedhojë, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit mbetet i pabazuar.

21. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *standardi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme nuk është respektuar edhe për shkak të formimit akademik dhe eksperiencës profesionale të trupës gjyquese të Komisionit, e cila në këtë aspekt ka qenë në pamundësi objektive për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për shkak të mungesës së qasjes së anëtarëve të saj ndaj ligjit penal dhe atij procedural*, trupi gjykues vlerëson se Kolegji nuk ka kompetencë kushtetuese dhe ligjore për të verifikuar formimin akademik apo eksperiencën profesionale të një anëtari të institucioneve të rivlerësimit.  
Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, vlen të theksohet qëndrimi i mbajtur nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin për çështjen Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë, duke trajtuar në mënyrë të detajuar të gjitha elementet e parimit të një gjykate të pavarur dhe të paanshme, ka arritur në përfundimin se si Komisioni, ashtu edhe Kolegji ishin të pavarur dhe të paanshëm, prandaj nuk ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së<sup>14</sup>.
22. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë mbi çmuarjen ligjore të provave, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si dhe duke evidentuar elemente të theksuara paragjykimi dhe të një vendimi të paracaktuar*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit e ka argumentuar këtë shkak ankimi duke parashtruar një sërë pretendimesh, si vijojnë.
  - (i) Komisioni nuk ka marrë në konsideratë asnjë argument dhe provë të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në kuadër të barrës së provës, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale.
  - (ii) Komisioni nuk ka përfshirë në mënyrë të qëllimshme në arsyetimin e vendimit faktin se të gjitha vendimet dhe akuzat e ngritura në dosjet penale nga subjekti i rivlerësimit, janë konsideruar të drejta nga gjykata, pa pasur as ankime nga palët për to.
  - (iii) Komisioni ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore pa dhënë asnjë shpjegim mbi shkaqet pse nuk janë vlerësuar provat e paraqitura nga ai, si dhe pa shpjeguar pse nuk ishte marrë parasysh kërkesa e subjektit për marrjen e provës me dëshmitarë.
23. Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se fakti që Komisioni ka arritur në konkluzione për çështje të caktuara me argumentin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë me provat e shpjegimet e paraqitura se ka një nivel të pranueshëm për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe aftësive profesionale, dëshmon në vetvete se provat e shpjegimet e paraqitura prej tij i janë nënshtruar një procesi analize e vlerësimi në përputhje me bindjen e brendshme të trupës gjyquese të Komisionit. Fakti që ky vlerësim i provave nga Komisioni është i ndryshëm nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se ka munguar vlerësimi i tyre, por tregon se provat e sjella pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, në këndvështrimin e tij, nuk kanë mundur të provojnë faktin ose rrethanën për të cilën janë paraqitur. Kodi i

<sup>14</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%5B%22document%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-208053%22%5D%7D>, paragrafët 280-317.

Procedurës Civile, në nenin 29 të tij, përcakton se gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e saj të çështjes. Edhe GjEDNj-ja, në jurisprudencën e saj, është shprehur se sipas nenit 6/1 të Konventës, vlerësimi i provave është kompetencë e gjykatave të brendshme, për pasojë nuk hyn në sferën e aplikimit të parimit të procesit të rregullt ligjor<sup>15</sup>, por, megjithëse gjykatat e brendshme kanë një marzh të caktuar vlerësimi, kur zgjedhin argumentet dhe vlerësojnë provat, është e detyrueshme për to të justifikojnë këto veprime duke i arsyetuar në vendim. Duke zbatuar jurisprudencën e mësipërme në çështjen konkrete, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, në vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, ka vlerësuar provat dhe ka arsyetuar mbi ato që i ka konsideruar relevante në zgjidhjen e drejtë të çështjes.

24. Në kuptim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka zhvilluar seancë dëgjimore publike, gjatë së cilës, pas relatimit të relatorit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime e ka parashtruar pretendimet e tij për të kundërshtuar rezultatet dhe gjetjet e hetimit administrativ, në ushtrim të së drejtës së tij për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar. Në vendim është bërë një analizë e plotë e provave, të cilat janë përdorur për vlerësimin e pasurisë, figurës dhe vlerësimit profesional. Për secilën pasuri të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet dhe pretendimet e subjektit duke i cituar ato herë pas here, si dhe janë dhënë shpjegimet për mospranimin e kërimit të provave me dëshmitarë. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se shpjegimet dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, janë administruar nga Komisioni, dhe se asnjë prej këtyre akteve nuk është refuzuar, përveç kërkesës për thirrje dëshmitarësh. Po ashtu, nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore të jenë parashtruar kërkesa apo debatuar çështje që lidhen me administrimin e provave që subjekti ka paraqitur në Komision. Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit lidhen kryesisht me kërkesa për hetim të thelluar (specifikisht për dosjen e Shërbimit Informativ Shtetëror) dhe për vijimin e procesit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Sa më sipër, trupi gjykues nuk evidentoi të dhëna, sipas të cilave vendimi i Komisionit të ketë qenë i paracaktuar apo i paragjykuar. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet i pakuptimtë, në kushtet kur nuk provohen motivet për një vendimmarrje të paracaktuar apo të paragjykuar. Për pasojë, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit mbetet i pabazuar.

25. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *dhënia e vendimit nga Komisioni në shkelje flagrante të ligjit dhe provave ka sjellë shkeljen e së drejtës së respektimit të jetës private, parashikuar në nenin 8, paragrafi 2 i KEDNj-së*, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka argumentuar këtë shkak ankimi me pretendimin se dhënia e vendimit nga Komisioni, në shkelje flagrante të ligjit dhe provave, ka sjellë pakësimin e të ardhurave dhe dëmtimin e rëndë të reputacionit profesional edhe për shkak të pasojave të parashikuara nga ligji për përjashtimin nga sistemi i drejtësisë.

Në përgjigje të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i procedurës së zhvilluar nga Komisioni, trupit gjykues i rezultoi se nuk ka shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe as shkelje flagrante të ligjit. Edhe GjEDNj-ja, në një situatë të ngjashme, në çështjen Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë, është shprehur se: *Gjykata vëren se, gjatë vlerësimit të zbatueshmërisë së nenit 8 në rastin aktual, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet sipas një qasjeje*

---

<sup>15</sup> Shih çështjen Centro Europa SRL dhe Di Stefano kundër Italisë, 2012 dhe çështjen Suominen kundër Finlandës, 2003.

*të arsyeshme: largimi i kërkueses nga detyra e gjyqtarës nuk ka asnjë lidhje me jetën e saj private. Blerja ose krijimi i asetëve mund të konsiderohet si një aspekt i jetës private, por nuk është numri ose madhësia e asetëve ose stili i jetës së një individi si i tillë, që të mund të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, por është pamundësia e individit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për blerjen ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij ose të saj. Në çdo rast, gjykata konsideron se një auditim i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të jetës private që në vetvete të trajtohet si një shkelje etike. [...] Në këto rrethana, gjykata nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji i vettingut në përgjithësi, dhe ndërhyrja në rastin e aplikantit në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, të renditura në nenin 8, paragrafi 2 i Konventës<sup>16</sup>.*

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë procesi i vlerësimit të secilit prej kriterëve të rivlerësimit ka ndjekur procedurën ligjore, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se konkluzioni negativ i Komisionit për dy prej tyre ka pasqyruar shkeljen e së drejtës së jetës private, duke dëmtuar reputacionin e tij profesional, gjendet i pabazuar.

*C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

26. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar të gjitha konkluzionet që ka mbajtur Komisioni pas kontrollit të pasurisë dhe verifikimit të deklarimeve të tij, duke pretenduar se vendimi i Komisionit, për sa u përket konkluzioneve lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, është i padrejtë për shkaqet e mëposhtme.
27. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit vlerësimi i Komisionit është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur përmbushen në mënyrë kumulative deklarami i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, ndërsa Komisioni për kriterin e kontrollit të figurës e ka konsideruar subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, për kriterin e kontrollit të figurës, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit<sup>17</sup> dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara, pasi për periudhën 2006-2016 ka një diferencë të pajustificuar me të ardhura të ligjshme.
28. Në analizë të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, deklarami i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sipas parashikimeve të nenit 39 dhe deklarami i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33, parashikohen si raste të veçuara në kuadër të pamjaftueshmërisë në

<sup>16</sup> Shih paragrafët 358-393 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë.

<sup>17</sup> Komisioni, në vendim, në paragrafin 78, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, ka arritur në përfundimin: “Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, të dhënat dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit - sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 - por ato do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të rivlerësimit të tij”.



deklarim. Vlerësimi për secilin prej tyre, bazohet në dispozita të ndryshme, të cilat trajtojnë dy kriterë të ndryshme të kontrollit në procesin e rivlerësimit.

Dispozita që legjitimon këtë mënyrë interpretimi është neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.*

Në kuptim të kësaj dispozite, vendimi për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, që do të thotë se ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit vetëm për një kriter dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, bazuar vetëm në një kriter vlerësimi. Në këtë kuptim, nuk kërkohet që deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë, të ekzistojnë detyrimisht njëkohësisht që të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, por mjafton vetëm njëri prej tyre për të arritur në këtë përfundim. Trupi gjykues thekson se Kolegji ka krijuar tashmë një jurisprudencë të konsoliduar në interpretimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se është e panevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se edhe ky shkak ankimi mbetet i pabazuar.

29. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *pasaktësia në deklarin e vlerës së pasurisë apartament banimi në qytetin e Burrelit dhe mosdeklarimi i shkëmbimit të saj me një apartament tjetër në po të njëjtin qytet, ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së subjektit të rivlerësimit, pa pasur si qëllim manipulimin e vlerës së blerjes së kësaj pasurie, as të fshehjes dhe as të deklarin të rremë të saj*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim të njëjtat argumente si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se vlera në kontratën e blerjes së pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 78,01 m<sup>2</sup> në qytetin e Burrelit, është përshkruar në shumën prej 1.565.392 lekësh, por duke qenë se apartamentin në fjalë e ka përfituar me statusin e të pastrehut, ka paguar vetëm dy këste: këstin e parë në vlerën 56.000 lekë dhe këstin e dytë në vlerën 239.090 lekë. Vlera në total është 295.090 lekë, ndërsa vlera e deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, prej 1.565.392 lekësh, është vlera sipas kontratës së shitjes. Në lidhje me ndryshimin e deklarin të vlerës së apartamentit në deklaratën e rivlerësimit nga ai në deklarin para fillimit të detyrës në ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se gabimisht ka vendosur vlerën e pagesës fillestare, duke e shprehur atë me lekë të vjetra [me një shifër më shumë]. Për sa i përket shkëmbimit të kësaj pasurie me apartamentin me sipërfaqe 70,9 m<sup>2</sup> që ai ka aktualisht në pronësi në qytetin e Burrelit, subjekti i rivlerësimit sqaron se shkëmbimi faktik i këtyre pasurive ka ndodhur në vitin 1996, ndërsa *de juro* është finalizuar në vitin 2013. Duke qenë se nuk ka pasur detyrime të ndërsjella mes palëve, si dhe duke qenë një marrëdhënie midis familjarëve [pasi shkëmbimi është realizuar me pasurinë e prindërve të vet], subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar të nevojshme që të deklaronte shkëmbimin.
30. Në lidhje me sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, në lidhje me kontrollin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin: [...] *subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Mospërputhjet midis deklarimeve të ndryshme lidhur me vlerën e apartamentit dhe mosdeklarimi nga ana e subjektit të*

*shkëmbimit të apartamentit me prindërit e vet, përbëjnë pasaktësi në deklaratimet vjetore, të cilat do të çmohen për peshën e tyre specifike, në një vlerësim tërësor të çështjes në fjalë<sup>18</sup>.*

Më tej, Komisioni në vlerësimin tërësor të çështjes, ka arsyetuar: [...] nga vlerësimi tërësor i të gjitha problematikave të pasqyruara në lidhje me të tria kriteret, ndër të cilat përmendim: deklaratime të pasakta dhe të pamjaftueshme në ILDKPKI; mosdeklarimin e shkëmbimit të apartamentit; dyshime të arsyeshme mbi integritetin e figurës, të ngritura nga organet ligjzbatuese dhe të konfirmuara nga informacionet me të cilat janë njohur anëtarët e trupit gjykues; mangësitë profesionale të përsëritura dhe dyshime të arsyeshme mbi favorizime të personave nën hetim, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut në figurën e prokurorit dhe, më gjerësisht në sistemin e drejtësisë dhe për rrjedhojë në rastin konkret duhet të aplikohet edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016<sup>19</sup>.

Nga sa më sipër, rezulton se Komisioni, në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, mosdeklarimin e shkëmbimit të apartamentit e ka konsideruar si një shkelje e cila ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe jo si deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet e tij.

31. Në analizë të pretendimeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton si vijon.

Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*Apartament banimi me sipërfaqe 70,9 m<sup>2</sup>, me adresë lagjja “{\*\*\*}”, Burrel, Mat, pronë e cila është përfituar me kontratën e shkëmbimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2013, me nr. pasurie {\*\*\*}, sipas certifikatës së pronësisë nr. {\*\*\*}, lëshuar më datë 26.11.2013 nga ZRPP Mat. Ky apartament është shkëmbyer me apartamentin me nr. pasurie {\*\*\*}, me certifikatë pronësie nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2002, pronësia e të cilit është përfituar me kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.11.2002, blerë nga Enti i Banesave Dibër në vlerën 1.565.39211 lekë, blerë me të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes sime.*

Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave në vitet 2013-2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shkëmbimin e pasurisë së tij me një tjetër, të kryer sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2013, si rezultat i së cilës ka përfituar apartamentin me sipërfaqe 70,9 m<sup>2</sup>, aktualisht në pronësi të tij.

Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në ankim.

Bazuar në situatën faktike të pasqyruar si më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se është i drejtë konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të interesave të vitit 2013, shkëmbimin e pasurisë së tij me një tjetër. Në lidhje me peshën e këtij mosdeklarimi në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk e ka vlerësuar atë si deklaratim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, por në vlerësimin tërësor të çështjes e ka konsideruar si shkak shkarkimi që çon në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këtë arsye, do të trajtohet në vijim në këtë vendim.

32. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, pasuria apartament me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup> në Tiranë, është krijuar nga subjekti i rivlerësimit me burime krejtësisht të ligjshme financiare, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, ka

<sup>18</sup> Paragrafi 37 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

<sup>19</sup> Paragrafi 179 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

arritur në përfundimin se shuma prej 3.600.000 lekësh, pjesë e depozitës prej 4.100.000 lekësh, e përdorur për kryerjen e pagesës për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup> në Tiranë, nuk mund të konsiderohet me burim të ligjshëm, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se z. M. V., vëllai i subjektit, të kishte siguruar të ardhura nga puna në Greqi, për të cilat të ishin paguar detyrimet tatimore dhe kontributet për sigurimet shoqërore. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme, për të kryer pagesën për blerjen e kësaj pasurie. Gjithashtu, Komisioni ka arritur dhe në përfundimin se subjekti, në deklaratat periodike për vitet 2007 dhe 2008, ka kryer deklarime të pamjaftueshme, pasi nuk ka deklaruar në rubrikën përkatëse ekzistencën e detyrimit të mbartur ndaj të tretëve [në rastin konkret shumën prej 3.600.000 lekësh ndaj vëllait të tij, z. M. V.].

33. Në kundërshtim të përfundimeve të arritura nga Komisioni në lidhje me kontrollin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar të njëjtat argumente si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se si burim krijimi për këtë pasuri, ka përdorur depozitën e përbashkët në emër të bashkëshortes së tij dhe vëllait të tij, në vlerën 4.100.000 lekë. Në lidhje me mosdeklarimin e këtij detyrimi ndaj vëllait të tij në deklaratat periodike të interesave, ai ka shpjeguar se nuk e ka deklaruar si detyrim borxhin ndaj vëllait, pasi e ka deklaruar si depozitë të përbashkët, për të cilën secili nga zotëruesit e depozitës ka pasur të drejta të njëjta në përdorimin e saj. Për këtë arsye, nuk është vlerësuar si marrëdhënie huamarrjeje, por si marrëdhënie mirëbesimi midis dy vëllezërve dhe kështu nuk kishte arsye për ta formalizuar me akte noteriale dhe as ta deklaronte si detyrim. Këtë detyrim ndaj vëllait të tij, subjekti i rivlerësimit shpjegon se e ka shlyer me anë të një kredie të marrë pranë Raiffeisen Bank, për rrjedhojë pasuria është krijuar me burime të ligjshme financiare. Edhe burimi financiar i kursimeve të vëllait të tij, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, është i ligjshëm, pasi të ardhurat e tij nga emigracioni kanë qenë vetëm nga puna e tij e ndershme si punëtor krahu në një magazinë fruta-perimesh në shtetin grek dhe puna si punëtor kuzhine në të gjitha vendet ku ka qenë emigrant ekonomik, punë e cila mund të jetë kryer në kushtet e mungesës së pagimit të sigurimeve shoqërore, por jo për faj të tij si punëmarrës.

34. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton si vijon.

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup>, kati i pestë, me adresë kompleksi i banesave të {\*\*\*} në Tiranë, pronë e cila është përfituar me aktmarrëveshjen nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.06.2007, blerë nga bashkëshortja ime në vlerën 40.500 euro, vlerë nga e cila nuk janë paguar 2.000 euro, pasi kjo vlerë do të paguhet në momentin e pajisjes me certifikatë pasurie për apartamentin. Ky apartament është blerë me kursimet në vite të miat dhe të bashkëshortes sime dhe të vëllait tim, shumë e cila është tërhequr nga depozita e përbashkët në bankën Societe Generale Albania, dega Burrel, në shumën 4.100.000 lekë. Vëllait tim M. V., ia kam kthyer shumën e marrë nga depozita e tij, pas marrjes së kredisë bankare nga ana ime me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.05.2009, pranë Raiffeisen Bank Burrel. Pjesa në %: 50%.*

- Pasuria apartament me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup> në Tiranë është në bashkëposedim të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten e tij, pasi ende nuk rezultoi të jetë marrë certifikata e pronësisë për këtë pronë. Pasuria është përfituar nëpërmjet aktmarrëveshjes [për apartament] nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.06.2007, të lidhur ndërmjet znj. F. V. [bashkëshortja e subjektit], në cilësinë

e porositësit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit. Sipas nenit 3 të aktmarrëveshjes, vlera e kësaj pasurie është 40.500 euro, vlerë e cila sipas nenit 5 do të paguhej në disa këste. Sipas këtyre parashikimeve kontraktore, deri në datën e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka likuiduar vetëm 38.500 euro, e konfirmuar kjo edhe nga deklarata/vërtetimi i shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, i datës 26.01.2017, të cilin subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit.

- Në deklaratimet periodike të interesave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e vitit 2007: “Prenotim banese me sipërfaqe 92 m<sup>2</sup> te qendra e banesave malajziane, Tiranë. Burimi i krijimit: Prenotimi i banesës është bërë në muajin korrik 2007 dhe paguhet me këste tremujore. Banesa ka vlerë 41.000 euro, nga e cila është likuiduar 33.250 euro. Kjo shumë është tërhequr nga Banka Popullore Burrel dhe Raiffeisen Bank. Vlera e paguar për këtë banesë është tërhequr nga Banka Popullore Burrel, depozitë bankare 4.100.000 lekë. Janë tërhequr nga banka edhe 1.000.000 lekë depozitë për pagesën e banesës”.

- Në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar: “Depozitë bankare Banka Popullore Burrel, në vlerën 4.100.000 lekë. Nga këto, 3.600.000 lekë i takojnë vëllait tim dhe 500.000 janë të familjes sime. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e disponuara në Spanjë prej 8 vitesh dhe nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes. Pjesa takuese 12%”.

- Nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga institucionet bankare, konfirmohet deklarimi i subjektit të rivlerësimit për depozitë bankare dyemërore të bashkëshortes së tij dhe vëllait të tij, në Bankën Societe Generale Albania<sup>20</sup>.

- Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar<sup>21</sup> në lidhje me marrëdhënien financiare me të vëllain dhe mbi burimin e të ardhurave të tij për shumën prej 3.600.000 lekësh, ka deklaruar se vëllai i tij, z. M. V., ka qenë emigrant, fillimisht në Greqi e më pas në Spanjë dhe ka punuar pa dokumente, për pasojë, nuk mund të provojë me dokumente burimin e këtyre të ardhurave.

Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.2019, të shtetasit Dh. V. dhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.04.2019, të shtetasve V. dhe J. V..

Shtetasi Dh. V. deklaroi se ka qenë emigrant në Greqi në vitet 2000-2004 dhe gjatë kësaj periudhe ka punuar së bashku me z. M. V. në ngarkim-shkarkim, transport etj., me një pagë që varionte në 1.000 - 1.200 euro në muaj.

Shtetasit V. dhe J. V. [vëllezërit e tjerë të subjektit të rivlerësimit] deklarojnë se në periudhën 1993-2003 kanë punuar në Greqi së bashku me vëllain e tyre M. V.. Paratë e fituara nga puna në këtë shtet, ata deklarojnë se ua kanë dërguar si kursime familjarëve të tyre në Shqipëri, të cilat janë depozituar në llogari të përbashkëta bankare me familjarët. Shtetasit deklarojnë se në shtetin grek kanë punuar pa qenë të siguar.

- Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, është shprehur se në vitin 2009 ka marrë një kredi bankare pranë Raiffeisen Bank, në shumën 3.000.000 lekë, shumë e përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj të vëllait të tij M. V., ndërkohë që në deklarinimin periodik vjetor për vitin 2009, nuk rezulton që të jetë deklaruar pagesa e kësaj shume si shlyerje detyrimi

---

<sup>20</sup> Informacioni është përcjellë në Komision nga Banka Societe Generale Albania, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.05.2018.

<sup>21</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 04.03.2019 dhe në ato të pyetësorit nr. 3, datë 08.04.2019.

financiar ndaj të vëllait. Nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank<sup>22</sup>, konfirmohet deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka marrë një kredi bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 3.000.000 lekë. Shuma e kredisë është disbursuar nga banka në datën 12.05.2009, nga e cila në datën 14.05.2009 është tërhequr *cash* shuma prej 2.730.000 lekësh.

Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shlyerjen e detyrimit financiar ndaj vëllait të tij, detyrim ky që nuk është deklaruar në rubrikat përkatëse as në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2008.

35. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, në raport me situatën faktike të pasqyruar si më sipër, trupi gjykues vlerëson si vijon.
36. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në deklaratat periodike të interesave, nuk e ka deklaruar si detyrim borxhin ndaj vëllait të tij, pasi e ka deklaruar si depozitë të përbashkët, për të cilën secili nga zotëruesit e depozitës ka pasur të drejta të njëjta në përdorimin e saj e për këtë arsye nuk është vlerësuar si marrëdhënie huamarrjeje, por si marrëdhënie mirëbesimi midis dy vëllezërve dhe kështu nuk kishte arsye për ta formalizuar me akte noteriale, dhe as ta deklaronte si detyrim e të deklaronte shlyerjen e tij, trupi gjykues vëren se, bazuar në nenin 4, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049/2003, datë 10.04.2003, “Mbi deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin e deklarimit të detyrimit/borxhit ndaj vëllait të tij në deklaratën periodike të interesave të vitit 2007, pasi siç e pranon edhe vetë, ai ka përdorur pjesën takuese të vëllait të tij në këtë depozitë. Në kushtet kur vërehet se kjo pasaktësi në deklarin e subjektit të rivlerësimit gjendet në deklarin periodik të interesave, trupi gjykues, në mbështetje të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, vlerëson se pamjaftueshmëria e deklarimit për deklarimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklarim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili do të mund të konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se burimi financiar i kursimeve të vëllait të tij është i ligjshëm, pasi të ardhurat e tij nga emigracioni kanë qenë vetëm nga puna e tij e ndershme si punëtor krahu në një magazinë fruta-perimesh në shtetin grek dhe puna si punëtor kuzhine në të gjitha vendet ku ka qenë emigrant ekonomik, punë e cila mund të jetë kryer në kushtet e mungesës së pagimit të sigurimeve shoqërore, por jo për faj të tij si punëmarrës, trupi gjykues vlerëson se, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pjesa e depozitës prej 4.100.000 lekësh, e cila i përkiste si pjesë takuese z. M. V. [vëllait të subjektit të rivlerësimit], e përdorur nga subjekti për kryerjen e pagesës për blerjen e pasurisë në shqyrtim, nuk mund të konsiderohet me burim të ligjshëm, pasi gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur dot të provojë që vëllai i tij kishte siguruar të ardhura nga puna në Greqi, për të cilat ishin paguar detyrimet tatimore dhe kontributet për sigurimet shoqërore. Madje, vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorëve, në seancën dëgjimore dhe në ankim, e ka përjashtuar këtë mundësi, duke pohuar se nuk mund të provonte pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, pasi vëllai i tij kishte punuar në Greqi në kushtet e mungesës së pagimit të sigurimeve shoqërore. Konsiderimi i

---

<sup>22</sup> Informacioni është përcjellë në Komision nga Banka Societe Generale Albania, me shkresën nr. [\*\*\*] prot., datë 02.05.2018.

remitancave nga emigracioni si të ardhura që nuk rrjedhin nga një burim i ligjshëm, nëse për to nuk arrihet të vërtetohet se janë paguar detyrimet tatimore, është një qëndrim i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit<sup>23</sup>.

37. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se këtë detyrim ndaj vëllait të tij e ka shlyer me anë të një kredie të marrë pranë Raiffeisen Bank, për rrjedhojë pasuria është krijuar me burime të ligjshme financiare, trupi gjykues vëren se, duke qenë se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e apartamentit është paguar në vitin 2007 duke përdorur pjesën takuese të depozitës së vëllait të tij, rezulton se këto para kanë shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie, në mungesë të disponimit prej subjektit të të ardhurave të veta. Shuma e kredisë prej 3.000.000 lekësh, e marrë nga subjekti në Bankën Raiffeisen në vitin 2009, ka shërbyer si burim për shlyerjen e detyrimit ndaj vëllait të tij, pra rreth 2 vjet më vonë. Në këto kushte, argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar në fakte e prova.
38. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të kryer pagesën për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup> në Tiranë, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
39. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë që disponon, pasi vlera totale e të ardhurave familjare në vite është më shumë se trefishi i vlerës së pasurive*, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka arritur në konkluzionin se: *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme dhe ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme - sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës - për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016<sup>24</sup>.*  
Komisioni ka arritur në këtë përfundim pas kryerjes së analizës financiare, në të cilën ka analizuar të dhënat që i përkasin periudhës 2006-2016. Në vlerësim të analizës financiare të kryer për këtë periudhë, duke analizuar të gjitha të dhënat e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e tij dhe të personave të lidhur, pasuritë si dhe likuiditetet në gjendje *cash* dhe në llogari bankare, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzime shkollimi, si dhe çdo shpenzim tjetër të deklaruar apo dokumentuar prej subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në konkluzionin se ai ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara, në masën prej 3.456.331 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se fakti i pasjes së të ardhurave totale gjatë periudhës së analizuar në vlerën 34.300.000 lekë dhe pasuri në vlerën 11.400.000 lekë, pra rreth trefishin e të ardhurave krahasuar me vlerën e pasurive, është një tregues absolut se ai ka pasur burime financiare për të krijuar këto pasuri.
40. Në analizë të këtij shkakun ankimi, trupi gjykues verifikoi vlerën e të ardhurave dhe pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe të provuara me dokumentacion justifikues, duke arritur

<sup>23</sup> Shih vendimet nr. 3, datë 17.7.2018; nr. 4, datë 25.10.2018; nr. 6 datë 13.9.2018; nr. 9 datë 24.10.2018.

<sup>24</sup> Paragrafi 180/i i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

në konkluzionin se, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, të ardhurat *neto* të familjes së tij, nuk janë sa trefishi i pasurisë *neto*. Por, pavarësisht këtij përfundimi, trupi gjykues vlerëson se kontrolli i kriterit të pasurisë nuk mund të jetë në asnjë rast një përlllogaritje e thjeshtuar e raportit të vlerës së të ardhurave *neto* në total dhe vlerës totale të pasurive për periudhën e marrë në analizë, pasi një vlerësim i tillë do të ishte në kundërshtim të plotë me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe atij nr. 9049/2003. Sipas përcaktimeve të këtyre dispozitave, ligjvënësi ka parashikuar parimin kushtetues të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tij. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që, krahas provueshmërisë së burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë, të provojë gjithashtu edhe se të ardhurat e tij, të personave të lidhur e të personave të tjerë të lidhur, jo vetëm janë të krijuara nga burime të ligjshme, por janë edhe të deklaruara e për to janë paguar detyrimet tatimore. Nga sa më sipër, rezulton se procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë është një proces kompleks që përfshin vlerësimin financiar në mënyrë të gërshetuar me interpretimin ligjor të rrethanave dhe fakteve që lidhen me krijimin e pasurisë, në drejtim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në kohën e krijimit të pasurisë përkatëse.

Në këtë logjikë, si dhe në mungesë të pretendimeve specifike të subjektit të rivlerësimit në lidhje me zërat e analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2006-2016, trupi gjykues verifikoi të dhënat e përdorura në këtë analizë, nga ku rezultoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e kursimeve të deklaruara, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera për periudhën 2006-2016, në vlerën 3.456.331 lekë, është i drejtë, duke e vendosur atë në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

#### *Ç. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës*

41. Komisioni, në vendim<sup>25</sup>, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, bazuar në analizën e provave dhe fakteve, ka arritur në përfundimin se: *Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, të dhënat dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por ato do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të rivlerësimit të tij.*

Lidhur me këtë përfundim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtimin e tij në ankim, duke pretenduar se *barra e provës është ndryshuar nga Komisioni në mënyrë formale, për t'i pamundësuar subjektit të rivlerësimit realizimin e së drejtës së mbrojtjes, pasi në bazë të raportit mbi kontrollin e figurës është paragjykuar i gjithë procesi i rivlerësimit ndaj tij, si dhe është paracaktuar vendimi përfundimtar nga Komisioni.*

<sup>25</sup> Paragrafi 78 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se kërkesa e bërë nga ana e Komisionit dhe përgjigja e dërguar nga DSIK-ja duke prodhuar një raport të dytë për të, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe nenin 39, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur mundësi objektive për t'u mbrojtur, edhe sepse informacioni për kontrollin e figurës nuk ka qenë i plotë, pasi nuk i është dhënë asnjë provë, si dhe nuk është konstatuar asnjë kontakt i papërshtatshëm me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

42. Lidhur me këtë shkak ankimi të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë {\*\*\*}. 2017, është përcjellë nga DSIK-ja në Komision, raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë {\*\*\*}.2018, DSIK-ja ka përcjellë në Komision, raportin e dytë për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}.2018, të KDZh-së. DSIK-ja ka sqaruar se ky raport, me konstatimin për papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Hysni Vata, përcillet në Komision në bazë të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me qëllim integrimin e informacioneve të institucionit të verifikimit, të ardhura pas afatit ligjor të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës për këtë subjekt rivlerësimi. Gjithashtu, DSIK-ja ka referuar se ky raport përcillet në përgjigje të kërkesës së Komisionit nr. {\*\*\*} prot., datë {\*\*\*}.2018, me lëndë “Kërkesë për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.
43. Në analizë të pretendimit të subjektit se kërkesa e bërë nga ana e Komisionit dhe përgjigja e dërguar nga DSIK-ja, duke prodhuar një raport të dytë për subjektin e rivlerësimit, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe nenin 39, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, rezulton se DSIK-ja ka rishikuar raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, për shkak të përfshirjes së informacioneve të ardhura nga organet verifikuese pas hartimit të raportit të parë për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se DSIK-ja në rishikimin e raportit dhe Komisioni në administrimin e këtij raporti të dytë për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit kanë vepruar brenda kompetencave kushtetuese e ligjore, pasi autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës është Komisioni që vepron në bashkëpunim me DSIK-në, bazuar në parashikimin e nenit 36, pika 1 e ligjit nr. 84/2016<sup>26</sup> dhe arsyetimin në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese<sup>27</sup>. Grupi i Punës pranë DSIK-së ka përgjegjësi ligjore të luajë rol aktiv në kontrollin e figurës e të vlerësojë të gjithë informacionin që i përcillet nga organet verifikuese të përfshira në procesin e rivlerësimit, në funksion të rolit ndihmës për organet e rivlerësimit, në drejtim të marrjes së një vendimi përfundimtar në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, rishikimi i raporteve fillestare të DSIK-së, pasi janë marrë

---

<sup>26</sup> Neni 36, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “1. Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës [...]”.

<sup>27</sup> Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese, shprehet se: “Gjykata vlerëson se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses tek të gjitha materialet përkatëse. [...] Sipas nenit 14 të ligjit (nr. 84/2016) relatori në çdo rast duhet të ndërmerret të gjitha procedurat për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjykuese. [...] Në përfundim, gjykata vlerëson se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga KPK-ja. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”.



informacione plotësuese nga institucionet verifikuese, është tashmë një praktikë e rregullt që i shërben verifikimit të plotë dhe të detajuar të kontrollit të figurës. Por pavarësisht kësaj, nga përmbajtja e vendimit, konstatohet se Komisioni i ka mbështetur konkluzionet për kontrollin e figurës në verifikimin që ka kryer vetë, bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, mbi rezultatet e të cilave i ka kaluar edhe barrën e provës subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim ka arsyetuar dhe konkluduar mbi gjetjet për këtë kriter. Konstatimi i grupit të punës së DSIK-së nuk ka qenë vendimtar në konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, pasi Komisioni ka vlerësuar se informacionet, të dhënat dhe dyshimet e ngritura nuk ishin të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e detyrës e, si të tilla, nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

44. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur mundësi objektive për t'u mbrojtur sepse informacioni për kontrollin e figurës nuk ka qenë i plotë, pasi nuk i është dhënë asnjë provë, si dhe nuk është konstatuar asnjë kontakt i papërshtatshëm me persona të përfshirë në veprimtari kriminale dhe se në bazë të raportit të figurës është paragjykuar i gjithë procesi i rivlerësimit për të dhe është paracaktuar vendimi, konstatohet se Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 01.07.2019, ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit e më datë 03.07.2019, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit është njohur me dokumentet e dosjes së hetimit paraprak administrativ, pasi në deklaratën e firmosur prej tij më datë 05.07.2019, ka pranuar se u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij me CD, që nuk ka vërejtje në lidhje me materialet e tërhequra, si dhe dokumentacioni është konform inventarit që shoqëron dosjen dhe i është vënë në dispozicion. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit është njohur me raportet e DSIK-së dhe më pas ka dorëzuar prapësimet në lidhje me rezultatet e hetimit të Komisionit. Sa më sipër, Komisioni ka mundësuar garancitë e duhura për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit mundësinë e mbrojtjes efektive.

Trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit, në bazë të raportit të figurës, është paragjykuar i gjithë procesi i rivlerësimit për të dhe është paracaktuar vendimi, pasi është një pretendim i pajustificuar e i pambështetur në asnjë fakt e provë që mund të ofrojë qoftë edhe indicie për paragjykim të procesit të rivlerësimit, e sidomos në kushtet kur Komisioni nuk e ka vlerësuar të mjaftueshëm raportin e DSIK-së, për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit, i parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, është i pabazuar.

#### *D. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

45. Referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit, rezulton se për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përtej kontrollit të ushtruar mbi çështjet e përzgjedhura në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është kryer kontroll mbi veprimtarinë e zhvilluar prej tij, për të cilën në Komision ka pasur denoncime nga publiku, në zbatim të nenit 43, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe një gjetje e përcjellë në Komision nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim "ONM"), në bazë të nenit B të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 10 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Gjetja e ONM-së konsiston në analizën dhe shqyrtimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, lidhur me disa procedime penale të hetuara prej tij në Prokurorinë pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Dibër, të gjitha të regjistruara për ushtrimin e ndjekjes penale për veprimtari kriminale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, që ka sjellë dëmtimin e shëndetit apo humbjen e jetës së shtetasve, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara, të cilat janë marrë në analizë, Komisioni ka arritur në përfundimin: *Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura, anomali dhe shkelje procedurale, të cilat sipas parashikimit të pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të korrigjohen nëpërmjet programit njëvjeçar të trajnimit. Si rrjedhim, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas shkronjës “c” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi tërësor dhe, kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016*<sup>28</sup>.

Subjekti i rivlerësimit ka ngritur në ankim, pretendime të tij për këtë konkluzion të Komisionit, të cilat analizohen në vijim.

46. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për kontrollin e aftësive profesionale, duke parashtruar se *Komisioni ka shkelur parimin e gjësë së gjykuar dhe parimin e sigurisë juridike, pasi vendimet e marra nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë prokurorit, të cilat janë bërë pjesë e kontrollit të Komisionit, kanë qenë më parë pjesë e kontrollit periodik nga Prokuroria e Përgjithshme, KLP-ja, Ministria e Drejtësisë e gjykatat, duke u vlerësuar si vendimmarrje të rregullta e të bazuara në ligje.*
47. Në lidhje me pretendimin si më sipër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit është parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës, si një proces i jashtëzakonshëm dhe kalimtar kontrolli për subjektet e rivlerësimit, i cili kryhet në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Qëllimi dhe objektivi i kontrollit të ushtruar përgjatë këtij procesi mbi të tria kriteret e rivlerësimit nuk janë të njëjtë me qëllimin dhe objektivin që ndjek kontrolli periodik, apo qoftë dhe i veçantë, që kanë kryer strukturat kontrolluese brenda sistemit të drejtësisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Parashikimet kushtetuese e ligjore nuk kushtëzojnë ushtrimin e kontrollit prej organeve të rivlerësimit, nga raportet apo rezultatet e kontrollit të ushtruar më parë prej strukturave përkatëse brenda organeve të sistemit të drejtësisë, madje në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, as raportet që hartohen nga këto institucione, si organe ndihmëse në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk kushtëzojnë vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit brenda fushës së tyre të veprimit. Për rrjedhojë, kontrolli nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme për ushtrimin e funksioneve profesionale të subjektit, nuk pengon, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, të drejtën e organeve të rivlerësimit për të kryer kontrollin dhe vlerësimin e tyre në mënyrë të pavarur e objektive për verifikimin e nivelit të aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 44 të po këtij ligji. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, nuk gjendet në kushtet e zbatimit të parimit të “gjësë së gjykuar”, për pasojë pretendimi i tij është i pabazuar.
48. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *çështjet penale nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} janë ende në procedurë gjykimi e, për pasojë, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk duhet të*

<sup>28</sup> Paragrafi 180/iii i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

*përfshiheshin nga Komisioni në vlerësimin e aftësive profesionale, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të ngarkuar me çështjen penale nr. {\*\*\*}, me vendimin e datës 20.11.2012, ka vendosur pushimin e procedimit penal, sepse nuk përmbusheshin elementet e veprës penale “Shkelje e rregullave të sigurisë në punë”. Mbi bazën e ankimit të djalit të njërit prej viktimave, Prokuroria e Përgjithshme vendosi shfuqizimin e vendimit dhe sugjeroi vijimin e hetimeve, duke caktuar detyra konkrete. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 12.05.2014, vendosi sërish pushimin e procedimit penal. E vënë në lëvizje nga ankimi i djalit të njërit prej viktimave, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 9, datë 27.10.2016, vendosi shfuqizimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes dhe urdhëroi vijimin e hetimeve. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, prokuroria vendosi sërish pushimin e procedimit penal. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.06.2018, vendosi të linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Ky vendim mori formë të prerë. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar Komisionin se aktualisht janë duke u kryer hetime për këtë çështje. Në vendim, Komisioni ka arsyetuar se: *Ky procedim mund të analizohet në funksion të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit Hysni Vata, pasi, edhe pse dosja, pas rikthimit është duke u hetuar (nga prokurorë të tjerë), vendimi i datës {\*\*\*}, i Prokurorisë së Rrethit Dibër për të mbyllur procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, nuk është një çështje në shqyrtim, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë se subjekti e ka shprehur përfundimisht qëndrimin e vet në vendimin që kishte marrë, i cili është vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e apelit. Në këtë drejtim, interpretues ka qenë edhe qëndrimi i mbajtur nga Kolegji i Apelit për çështje të ngjashme në vendimin nr. 7/2019<sup>29</sup>.**

49. Në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e mësipërm të Komisionit se çështja nr. {\*\*\*} nuk mund të konsiderohet si një çështje në shqyrtim, pasi Komisioni ka vlerësuar vetëm vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal, i cili rezulton të ketë qenë i zgjidhur në mënyrë përfundimtare, sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në momentin e vlerësimit nga Komisioni, kjo çështje nuk ka qenë në proces shqyrtimi nga subjekti i rivlerësimit, pasi subjekti ka dhënë për të një vendim përfundimtar dhe aktualisht çështja është duke u hetuar nga prokurorë të tjerë. Për rrjedhojë, Komisioni nuk ishte në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për vlerësimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} në funksion të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
50. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, që i përket çështjes nr. {\*\*\*}, rezulton se kjo çështje në vendimin e Komisionit është referuar si denoncimi i datës 10.04.2019, i znj. N. C., sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka pushuar një hetim mbi falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara për të përfituar një trashëgimi të bashkëshortit të saj. Komisioni, pasi ka analizuar materialin e administruar në lidhje me këtë çështje, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal pa kryer hetime të plota dhe gjithëpërfshirëse duke mbërritur në konkluzione hetimore të cunguara, të cilat nuk përputhen me faktet e konstatuara. Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se kjo çështje, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk duhej të përfshihej nga Komisioni në vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se Komisioni ka vlerësuar vetëm vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal, duke qenë se subjekti e ka shprehur përfundimisht

<sup>29</sup> Paragrafi 139 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

qëndrimin e vet në këtë vendim. Në këto kushte, Komisioni, sa i takon vlerësimin mbi pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, nuk ishte në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.

51. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, ka qenë në përputhje të plotë me ligjin*, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, ka vlerësuar se në këtë procedim ka pasur mangësi në hetime, mangësi të kryera nga subjekti i rivlerësimit jo vetëm si drejtues i prokurorisë, por edhe si urdhërues dhe përmbushës i disa veprimeve hetimore në këtë dosje, ndonëse për këtë detyrë, zyrtarisht dhe formalisht, ishte deleguar prokurori R.T.. Sipas Komisionit, kjo qasje proaktive e z. Hysni Vata në kryerjen e disa veprimeve hetimore personalisht, rezultoi në kapërcim të kompetencave të drejtuesit, sipas të cilave ai vetëm duhej të verifikonte aktin përfundimtar të hetimeve duke e miratuar apo shfuqizuar atë. Nga ana tjetër, konfirmon (edhe pse në mënyrë të tërthortë) dyshimet e ngritura nga informacione të klasifikuara, lidhur me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në këtë procedim. Nga sa më lart, Komisioni ka vlerësuar se, në këtë dosje të përfunduar me një vendim pushimi të dyshimtë dhe me hetime të paplota, subjekti i rivlerësimit nuk ka evidentuar mangësitë hetimore, në cilësinë e drejtuesit, dhe ka miratuar një vendim pushimi të pabazuar në fakte. Subjekti i rivlerësimit ka pasur një përfshirje të tejskajshme në këtë procedim, në kapërcim të kompetencave të tij e në kundërshtim me detyrimin e shtuar të magjistratit në respektimin e kompetencave institucionale, si dhe me parimin e paanshmërisë, rrethana këto që cenojnë besimin e publikut te figura e prokurorit.
52. Nga analizimi i të dhënave të pasqyruara në vendim dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se në datën {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit dhe drejtuesit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, ka urdhëruar kryerjen e regjistrimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, në ngarkim të shtetasit I. K. dhe ka ngarkuar prokurorin R.T. për kryerjen e hetimeve. Në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për vlerësimin e masës së sigurimit personal arrest me burg ndaj personit të akuzuar, në Gjykatën e Shkallës së Parë, Dibër. Në datën {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar prokurorinë në seancën gjyqësore, në të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në fjalë dhe ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest në burg”, me afat 30 ditë. Në datën {\*\*\*}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, duke pranuar kërkesën e të akuzuarit, ka revokuar vendimin nr. {\*\*\*}, për dhënien e masës së sigurisë “arrest në burg” me afat 30 ditë dhe ka urdhëruar lirimin e tij, pasi edhe prokuroria kishte kërkuar zëvendësimin e masës së mësipërme me atë “detyrim paraqitjeje pranë policisë gjyqësore”. Në datën {\*\*\*}, prokurori R.T., pasi ishën kryer veprimet hetimore, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të regjistruar ndaj shtetasit I. K., me arsyetimin se ai nuk ka kryer vepër penale.
53. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të konkluzioneve të arritura nga Komisioni, vlerëson si vijon. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se, ndaj vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, nuk është ushtruar ankim nga palët e interesuara te drejtuesi i prokurorisë dhe as në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, nuk mund të konsiderohet si argument i bazuar, pasi mungesa e ankimit nga palët e interesuara, e cila mund të ketë ardhur për arsye objektive e subjektive të vlerësuara prej vetë atyre, nuk do të thotë që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është e drejtë.

54. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se veprimet e kryera prej tij në këtë procedim penal janë kryer për shkak se prokurori i gatshëm R.T. ka qenë jashtë territorit të Prokurorisë Dibër, në datën e regjistrimit të procedimit penal, nga verifikimi i akteve të dosjes penale të procedimit penal nr. {\*\*\*}, nuk rezultoi të ketë akt që argumenton arsyen dhe kushtet përse veprimet hetimore janë kryer nga subjekti i rivlerësimit Hysni Vata dhe jo prej prokurorit të ngarkuar për çështjen. Trupi gjykues vëren se urdhri nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, lejon prokurorin e çështjes të diskutojë paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë në lidhje me vendimmarrje të caktuara, me synim për të parandaluar pasojat që mund të shkaktojë një vendimmarrje e pabazuar në ligj e në prova. Por, veprimet e subjektit të rivlerësimit në këtë procedim penal kanë shkuar përtej parashikimit të mësipërm, pasi ai ka kryer vetë veprimet hetimore dhe procedurale duke përfaqësuar organin e akuzës në gjykimin për caktimin e masës së sigurisë, megjithëse kishte ngarkuar prokurorin R.T., zyrtarisht dhe formalisht për ndjekjen e procedimit penal. Në këtë kuptim, qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur një përfshirje në kapërcim të kompetencave të tij, vlerësohet i drejtë nga trupi gjykues.
55. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, për sa i përket arsytimit të vendimit të pushimit të çështjes, konkludimi mbi rezultatin e hetimeve është e drejtë ekskluzive e prokurorit të çështjes, trupi gjykues çmon të saktësojë se Komisioni, në vendim, ka konkluduar për mungesë të hetimeve në çështjen në fjalë<sup>30</sup> dhe jo për problematika në arsytimin e vendimit të pushimit të procedimit penal. Sipas konstatimeve të Komisionit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor për verifikime të mëtejshme, me qëllim qartësimin dhe përcaktimin e versionit real mbi dinamikën dhe rrjedhën e ngjarjeve, ditën që kishte ndodhur aksidenti rrugor. Gjithashtu, një tjetër mangësi hetimore konsiston në mosngritjen e dyshimeve nga prokuroria dhe në mosverifikimin e mëtejshëm të fakteve, lidhur edhe me konsumimin e mundshëm nga ana e dëshmitarit (Xh. K.), të veprës penale të deklarimit të rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore, e parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal. Këto konstatime të Komisionit, pas verifikimit, u gjetën të drejta nga trupi gjykues, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar me përgjegjshmëri detyrat e tij, sipas mekanizmave që ligji i kohës<sup>31</sup> dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm<sup>32</sup> parashikonin për të mbikëqyrur ecurinë dhe përfundimin e çështjes. Kuadri ligjor i

<sup>30</sup> Në verifikim të dokumentacionit të dosjes së procedimit penal nr. {\*\*\*}, konstatohet se ka mospërputhje midis deklaramëve të personit nën hetim, I. K., dhe deklaramëve të dëshmitarit Xh. K. Gjithashtu, rezulton mospërputhje midis konkluzioneve përfundimtare të prokurorisë dhe fakteve që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen penale. Konkretisht, në datën {\*\*\*}, sipas procesverbalit të marrjes së të dyshuarit në pyetje, rezulton se shtetasi I. K. ka pohuar: “[...] gjatë udhëtimit me mua në makinë ka qenë kushëriri im, që quhet E. Sh. K. [...]”. Ndërsa, nga procesverbali i policisë, nga akti i ekspertizës dhe po ashtu edhe nga deklaramet e dëshmitarit XH. K., rezulton se pasagjeri në mjet (kamion), në momentin e aksidentit, që drejtohej nga personi nën hetim, kishte qenë shtetasi Xh. Sh. K. dhe jo shtetasi E. Sh. K. Gjithashtu, rezultoi se personi nën hetim, I. K., ka deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore, në datën {\*\*\*}, se po në atë datë, gjatë udhëtimit të nisur nga Fushë-Kruja dhe derisa kanë mbërritur në Bulqizë (vendi i aksidentit), “nuk kemi ndaluar në asnjë vend”. Por, nga ana tjetër, dëshmitari dhe bashkudhëtari me të akuzuarin, i pyetur në datën e aksidentit, 26.11.2011, ka deklaruar se përgjatë udhëtimit në fjalë, ata kishin ndaluar në Milot dhe kishin konsumuar ushqim.

<sup>31</sup> Kodi i Procedurës Penale parashikonte në nenin 24, pikat 4 dhe 5:

“4. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

5. Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht”.

<sup>32</sup> Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, parashikonte: “3. Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, para se të shkruajnë shkresat për kalimin e akteve të prokurorit në gjykatë ose te subjektet e tjera të procedimit penal, [...] kanë për detyrë të kontrollojnë

kohës garantonte pavarësinë e prokurorit të çështjes në vendimmarrjen e tij, por nuk përjashtonte mjetet e kontrollit dhe marrjes së vendimeve nga prokurorët më të lartë, me qëllim unifikimin e mënyrës së ushtrimit të funksioneve në prokurori, për zgjidhjen e çështjeve bazuar në ligj e prova, në kushtet kur prokuroria funksiononte si një organ i centralizuar. Trupi gjykues, në vlerësimin e tij, mban në konsideratë që përfshirja e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje si prokuror në seancë, po ashtu dijenia dhe vëmendja që ai ka pasur lidhur me të, ka qenë më e madhe se ajo e çështjeve të tjera, në të cilat ai kishte qenë thjesht dhe vetëm në rolin e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se konkludimi mbi rezultatin e hetimeve është e drejtë ekskluzive e prokurorit të çështjes, mbetet një pretendim i pabazuar në dispozita ligjore dhe, për më tepër, një justifikim në shmangie të përgjegjësiqve që një drejtues prokurorie duhet të kishte në ushtrimin e funksioneve të tij.

56. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, në procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me masën e dënimit me burgim, ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim<sup>33</sup> ka konkluduar se: *Komisioni vlerëson se, lidhur me sa më lart, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi në veprimet hetimore nga subjekti i rivlerësimit, por rezulton se ky i fundit ka kërkuar një dënim përfundimtar, minimal, prej dy vitesh burg, pa bërë ndonjë argumentim logjiko-faktik lidhur me këtë zgjedhje. Ndërkohë që, nga dokumentacioni i administruar, nuk kanë shikatur shkaqe apo rrethana lehtësuese që mund të justifikonin një kërkesë për një masë të tillë dënimi, pro të dyshuarit, në një kohë që nga parashikimi ligjor, dënimi i mundshëm niste nga 3 vjet dhe mund të shkonte deri në 10 vjet burg.*
57. Nga analizimi i të dhënave të pasqyruara në vendim dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, rezulton se në gjykimin për procedimin penal të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, gjatë gjykimit të çështjes, në konkluzionet e tij përfundimtare, ka kërkuar dënimin e të pandehurit me 3 vjet burg për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, sipas nenit 88/1 të Kodit Penal. Më datë {\*\*\*}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. {\*\*\*}, ka dënuar shtetasin E. L. me 3 vjet e 6 muaj burg, duke ia ulur dënimin me 1/3, në 2 vjet e 4 muaj, në saje të aplikimit të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, pasi është gjykuar me gjykim të shkurtuar. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.10.2015, në të cilin ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në pjesën e pavuajtur të dënimit dhe ka caktuar një afat prove prej 18 muajsh për shtetasin E. L.
58. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se, në çështjen në fjalë, ka kërkuar atë masë dënimi nisur nga rrethanat e çështjes: normalizimi i marrëdhënieve mes familjes së të pandehurit dhe asaj të viktimës, të cilat ishin dhe në lidhje krushqie me njëra-tjetrën, pasojës së ardhur, rrezikshmërisë së të pandehurit dhe të faktit se ka qenë i padënuar më parë, moshës së tij, pendesës për veprimin e kryer, njohjes së tij si një person joproblematik në shoqëri dhe jo në konflikt të vazhdueshëm me ligjin.

---

*bazueshmërinë në ligj të akteve dhe të procedimit penal. Ata marrin përgjegjësi për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe/ose formulimin e aktit nga prokurori më i ulët.*

*4. Në rastet kur nga kontrolli kryesisht ose mbi ankim, drejtuesi i prokurorisë ose prokurori më i lartë çmojnë se mënyra e përfundimit të hetimit dhe/ose akti procedural i marrë nga prokurori nuk është i mbështetur në ligj dhe/ose në prova apo akti është i paarsyetuar, sipas rastit, ai mund të vendosë:*

*4.1 ndryshimin ose shfuqizimin e aktit dhe zgjidhjen ligjore përfundimtare të procedimit, ose;*

*4.2 riformulimin e aktit: [...]”.*

<sup>33</sup> Paragrafi 120 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

59. Në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit lidhur me qëndrimin e mbajtur në vlerësimin e qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim penal, trupi gjykues e gjen të paqartë arsytimin e Komisionit në drejtim të përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në rastin konkret, pasi edhe Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, madje ka caktuar një afat prove prej 18 muajsh për shtetasin E. L. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se arsytimi i Komisionit në lidhje me masën e dënimit të kërkuar nga subjekti i rivlerësimit në gjykimin e kësaj çështjeje, është në tejkalim të standardit ligjor për vlerësimin e prokurorit, i vendosur në nenin 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016<sup>34</sup>, pasi kërkitimi i prokurorit të çështjes në lidhje me masën e dënimit, bazohet në interpretimin dhe logjikën e prokurorit mbi bazën e materialit provues të rezultuar nga hetimi. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e konstatuara nga Komisioni lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit {\*\*\*}, janë të pamjaftueshme për të arritur në ndonjë përfundim në lidhje me pasojat e veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, për t'i konsideruar si një shkelje në përputhje me përcaktimet e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
60. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimi për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, ka qenë plotësisht i arsyetuar dhe i bazuar në prova dhe në ligj*, trupi gjykues vëren se, pasi ka marrë në shqyrtim dhe analizë këtë procedim penal, të analizuar hollësisht edhe në gjetjen e ONM-së, Komisioni, në vendim<sup>35</sup>, ka arritur në konkluzionin se: *[...] vendimi i pushimit në fjalë rezulton i pabazuar në fakte dhe i motivuar në mënyrë sipërfaqësore dhe i pa argumentuar mjaftueshëm. Procedimi, i konkluduar me këtë vendim pushimi jo bindës, evidenton një sërë problematikash, si: mangësi hetimore; analizë jo objektive mbi faktet e dinamikës së aksidentit dhe lidhjes së tij shkak-pasojë me pasigurinë e frontit të punës në galerinë nr. {\*\*\*}; arsyetim të dobët dhe të pambështetur në prova; dyshime për favorizim të personave nën hetim - duke konfirmuar në këtë mënyrë edhe dyshimet e ngritura nga burimet konfidenciale dhe nga informacionet e klasifikuara - me pasojë cenimin e besimit të publikut të figura e prokurorit/magjistratit.*
61. Në kundërshtim të konkluzionit si më sipër cituar të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur, se vendimmarrja për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është bazuar në këqyrjen e vendit të ngjarjes, këqyrjen e kufomës, aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, aktekspertimet teknike, në deklaratimet e personave që kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes, si dhe në të gjitha aktet e tjera të administruara në tërësi. Në këtë vendim është përshkruar qartë fakti penal, rrethanat e këtij fakti, analiza e tyre, si dhe arsytimi i tyre në mënyrë të detajuar, duke konkluduar se për rastin në fjalë nuk ka asnjë element të ndonjë veprë penale dhe as të veprës penale për të cilën është regjistruar çështja penale. Në gjykimin e subjektit të rivlerësimit, janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme, përfshirë këtu dy akte ekspertimi tekniko-minerare me grupe ekspertësh, të cilat kanë përcaktuar shkakun determinant të ardhjes së pasojës në këtë veprë penale. Gjithashtu, subjekti pretendon se ndaj vendimit të pushimit, nuk është ushtruar as ankim administrativ dhe as ankim ligjor nga subjektet e këtij hetimi, fakt i cili provon edhe një herë bazueshmërinë e vendimmarrjes.

<sup>34</sup> Neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 parashikon: “4. Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.

<sup>35</sup> Paragrafi 134 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

62. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar se:  
Më datë {\*\*\*}, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, e parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, mbi kallëzimin e Policisë së Bulqizës, se më datë {\*\*\*}, shtetasi B.P. u plagos dhe ndërroi jetë në punë, në minierën e kromit të administruar nga kompania “{\*\*\*}” ShPK, në Bulqizë.  
Më datë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke arritur në konkluzionin se vdekja e punonjësit B.P. erdhi prej fajit të tij, sepse ai dhe kolegët e tij, sipas urdhrit të administratorëve të kompanisë, nuk duhet të kishin punuar të shtunave dhe të dielave, por ata dolën në punë me iniciativën e tyre.  
Ky përfundim është bazuar në dëshmitë e punonjësve që kishin punuar me viktimën në të njëjtën ditë. Sipas dëshmive të tyre, ata kishin shkuar të punonin të shtunën, sepse kishin nevojë për para. Nëpunësit e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK kanë dëshmuar se punëtorët ishin atje me iniciativën e tyre, edhe pse ishin urdhëruar që askush të mos punonte të shtunave dhe të dielave, por nuk kanë paraqitur asnjë provë shkresore për të provuar dhënien e këtij urdhri.  
Rojet e galerisë nr. {\*\*\*}, ku ndodhi aksidenti, kanë pretenduar se viktima ishte marrë në telefon nga administratori dhe i ishte thënë se askush nuk duhet të punonte të shtunën dhe të dielën dhe se ai i tha ekipit të punëtorëve, përfshirë viktimën, se nuk u lejohej të punohej atë ditë, por megjithatë, ata këmbëngulën që të punonin dhe me vullnetin e tyre nënshkruan një procesverbal për këtë.  
Nga verifikimi i akteve të procedimit penal, rezulton se ky procesverbal i pretenduar është një faqe fletoreje vetëm me emra të shkruar me dorë të punëtorëve, pa nënshkrime [firma], dhe data është shkruar me dorë, {\*\*\*}.  
Në datën e ndodhjes së aksidentit, më {\*\*\*}, shtetasi B. P., nuk kishte kontratë pune me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.
63. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vendimmarrja për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është bazuar në rezultatet e veprimeve hetimore të kryera, në raport me pasqyrimin e rrethanave faktike të pasqyruara në paragrafin më sipër në këtë vendim, trupi gjyqësor vëren se në arsyetimin e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, argumenti kryesor i vendimmarrjes është fakti se në ditën që ka ndodhur aksidenti vdekjeprurës, viktima dhe kolegët e tij nuk duhet të ishin paraqitur në punë, pasi sipas urdhrit të administratorëve të shoqërisë, nuk duhet të punonin të shtunave dhe të dielave, por ata kishin dalë në punë me iniciativën e tyre. Subjekti i rivlerësimit ka arritur në këtë konkluzion, pa administruar përgjimet telefonike midis administratorit dhe rojës në ditën e aksidentit, kur roja pretendonte se nga administratori i ishte njoftuar urdhri që të mos punohej ditën e shtunë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime në lidhje me procesverbalin e pretenduar, në të cilin evidentohen një sërë elementesh, të cilat vënë në dyshim vërtetësinë e tij në raport me ngjarjen e ndodhur, për shkak se është vetëm një fletë letre me emra të shkruar me dorë, pa nënshkrime, që në këto kushte nuk vërteton në asnjë rast se emrat janë shkruar nga punëtorët dhe, për më tepër, nuk arrihet dot në një përfundim mbi arsyen e hartimit të kësaj liste me emra. Data që mban letra është {\*\*\*}, ndërsa aksidenti ka ndodhur më datë {\*\*\*}. Përveç kësaj, vajtja në punë e viktimës ditën e shtunë, nuk justifikon mungesën e sigurisë teknike të mjaftueshme si shkak aksidenti, për sigurinë e së cilës kompania punëdhënëse ka pasur detyrim ligjor. Nga aktet e dosjes, nuk rezulton e provuar që aksidenti të ketë ndodhur në një zonë ku viktima nuk duhej të kishte akses, përkundrazi, ai është mbuluar nga masa shkëmbore duke punuar, pikërisht në frontin e punës, siç ka pohuar njëri nga punëtorët që punonte bashkë me të atë ditë. Në datën e ndodhjes së aksidentit, më {\*\*\*}, viktima



nuk kishte kontratë pune me shoqërinë dhe, për këtë arsye, as nuk duhej të ishte lejuar të punonte. Në momentin që siguria teknike në punë në minierën e Bulqizës, përbënte objektin e hetimit, në vendimin e pushimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit duhej të kishte qartësuar, analizuar dhe argumentuar, mbi prova konkrete, nëse masat e sigurisë plotësonin të gjithë parametrat tekniko-ligjorë. Subjekti i rivlerësimit duhet të verifikonte nëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë<sup>36</sup>, personat përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë pranë subjektit minerar, kishin nxjerrë akte, por dhe informuar dhe formuar punëmarrësit për zbatimin e këtyre masave, si dhe dokumentin e vlerësimit të riskut, në të cilat evidentohen masat për të bërë të sigurt vendin e punës, me qëllim përjashtimin e këtij elementi si shkak të ndodhjes së aksidentit. Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit se të punuarit në kundërshtim me urdhrin ka qenë shkak i aksidentit, nuk ka lidhje direkte me pasjen apo jo të sigurisë teknike brenda galerisë. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit nuk është mbështetur në kryerjen e hetimeve të plota që do të çonin në një përfundim të saktë mbi ekzistencën e veprës penale.

64. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme, përfshirë këtu dy akte ekspertimi tekniko-minerare me grupe ekspertësh, të cilët kanë përcaktuar shkakun determinant të ardhjes së pasojës në këtë vepër penale, trupi gjykues vëren se në aktet e dosjes së procedimit penal gjenden dy akte ekspertimi tekniko-minerare, në të cilat është arritur në përfundimin se shkak i ngjarjes që ka sjellë si pasojë humbjen e jetës së shtetasit B. P., është mosrespektimi i rregullave të sigurisë teknike në punë nga vetë i aksidentuari. Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se aktet e ekspertimit nuk arrijnë të krijojnë lidhje logjike shkakësore të besueshme ndërmjet veprimit/mosveprimit të viktimës dhe ngjarjes së ndodhur. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se akti i ekspertimit është një provë shkencore me të njëjtën vlerë me provat e tjera, e cila merr vlerën dhe fuqinë e saj provuese në koherencë me provat e tjera të mbledhura gjatë hetimit, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk duhet t'i kishte dhënë aktit të ekspertimit vlerë të pakontestueshme. Analiza sipërfaqësore e fakteve të cilat kanë rezultuar vetëm nga veprimet e para hetimore dhe nuk janë ndjekur nga hetime më të thelluara, në bazë të së cilës subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal, me të drejtë i ka shërbyer Komisionit si një çështje me ndikim në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
65. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal, nuk është ushtruar as ankim administrativ dhe as ankim ligjor nga subjektet e këtij hetimi, fakt i cili provon edhe njëherë bazueshmërinë e vendimmarrjes, trupi gjykues vëren se është një argument i dhënë nga subjekti i rivlerësimit edhe në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore në Komision. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues gjen të drejtë arsyetimin e Komisionit, se ky pretendim nuk rezulton të ketë forcë argumentuese,

---

<sup>36</sup> Neni 4, pika 4 e ligjit nr. 10237/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", parashikon: "4. Detyrimet e punëmarrësve në fushën e sigurisë e të shëndetit në punë nuk cenojnë parimin e përgjegjësisë së punëdhënësit".

Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë janë:

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 5.5.2010, "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier""; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë"; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 969, datë 02.12.2015, "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit të punëmarrësve në industrinë minerare nxjerrëse, sipërfaqësore dhe nëntokësore"; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 6.8.2014, "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punëmarrësve lidhur me punën e krahut me ngarkesa".

sepse duke pasur parasysh rrethanat dhe kushtet sociale e ekonomike, në të cilat ndodhen familjet e minatorëve, është e qartë vështirësia dhe pamundësia e tyre kryesisht financiare, për t'iu drejtuar organeve të sistemit të drejtësisë, për më tepër që menjëherë pas një ndodhie tragjike në familje, ata nuk kanë pasur as qetësinë dhe as kthjelltësinë për të menduar mbi ecurinë e hetimeve në fjalë. Trupi gjykues vëren se pretendimi i analizuar më sipër, është një argument që përsëritet nga subjekti i rivlerësimit për secilën prej çështjeve penale të trajtuara nga Komisioni në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Për pasojë, trupi gjykues çmon të mbajë të njëjtin qëndrim në vlerësimin e çështjeve në vijim në lidhje me këtë pretendim, edhe për faktin se rrethanat e hetimit janë të ngjashme, duke qenë se kanë të bëjnë me hetimin e veprës penale “Shkelje e rregullave të sigurisë në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, në minierat e Bulqizës.

66. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se lidhur me procedimin penal me nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016<sup>37</sup>. Për pasojë, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
67. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimi për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është vlerësuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, konform kërkesave të ligjit*, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim<sup>38</sup>, ka arritur në konkluzionin se: *[...] vendimi në fjalë, i marrë nga subjekti Hysni Vata, është marrë duke u bazuar në rrethana të verifikuara vetëm pjesërisht dhe pa kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, si dhe pa administruar prova të besueshme, të cilat do të çonin në nxjerrjen e një përfundimi të saktë në lidhje me ekzistencën e elementeve të veprës penale. [...] Bazuar në sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se pikërisht për këto çështje, trupi gjykues ka parë informacione konfidenciale pranë organeve ligjzbatuese që i referohen favorizimit që subjekti i rivlerësimit ka kryer për personat nën hetim, trupi gjykues çmon se kjo lloj qasjeje në hetime, mangësitë profesionale hetimore të konstatuara, si dhe vendimmarrjet nga ana e subjektit, kanë çuar në cenimin e besimit të publikut ndaj figurës së prokurorit.*
68. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se në lidhje me vendimin e prokurorit të çështjes R. K., për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, pas studimit të dosjes së procedimit penal, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se vendimmarrja e prokurorit ka qenë konform kërkesave ligjore. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar asnjë ankim administrativ apo ankim ligjor, deri më datë 08.04.2013, kohë në të cilën ai ka qenë ende në detyrën e drejtuesit të prokurorisë. Edhe pas shfuqizimit të këtij vendimi nga Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së detyrave të lëna nga ky organ, procedimi penal është pushuar përsëri nga një prokuror tjetër dhe vendimi i ri i pushimit nuk është shfuqizuar nga drejtuesja e prokurorisë në atë kohë, e cila aktualisht është konfirmuar nga Komisioni në detyrën e prokurores.
69. Nga verifikimi i vendimit nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se:

<sup>37</sup> Neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, parashikon: “2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”.

<sup>38</sup> Paragrafët 140-141 të vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

Prokuroria e Rrethit Dibër, më datë {\*\*\*}, ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, në vijim të kallëzimit të policisë të datës {\*\*\*}. Policia ka referuar për një ngjarje të ndodhur në fshatin {\*\*\*}, ku në brendësi të tunelit që po ndërtonte subjekti privat “{\*\*\*}” janë gjetur pa jetë shtetasi N. H., me detyrë minator dhe Q. Sh., me detyrë roje dhe mirëmbajtës i kompresorëve dhe ventilatorit. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor, ka rezultuar se shkak i vdekjes së viktimave ka qenë helmimi nga gazrat helmuese të tunelit. Po kjo prokurori, në datën {\*\*\*}, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, sepse nuk plotësohen elementet e veprës penale “Shkelje e rregullave të sigurisë në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim z. E. Sh., i biri i njërit prej viktimave. Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve dhe duke përcaktuar edhe veprimet hetimore që duhet të kryheshin, si sekuestrimi i procesverbalit origjinal të instruktimit teknik të datës {\*\*\*} dhe mbi të të kryhej akti i ekspertimit grafik për të përcaktuar nëse ky procesverbal ishte nënshkruar apo jo nga i ndjeri Q. Sh., si dhe kryerja e aktit të ekspertimit teknik për të përcaktuar nëse nga personat nën hetim ka apo jo shkelje të rregullave të sigurisë në punë. Në zbatim të këtyre detyrave, Prokuroria Dibër ka marrë vendimin për kryerjen e aktit të ekspertimit grafik, por nga Policia Shkencore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është kthyer përgjigje se nuk mund të përcaktohej nëse nënshkrimi ishte apo jo i të ndjerit Q. Sh., pasi dokumenti objekt ekspertimi ishte fotokopje dhe jo origjinal, duke i kërkuar prokurorisë Dibër të vinte në dispozicion aktin origjinal. Gjatë hetimit është kryer dhe akti i ekspertimit tekniko-minerar, sipas të cilit ngjarja ka ndodhur për faj të viktimave, të cilët nuk kishin zbatuar urdhrin e datës {\*\*\*}, për pezullimin e punimeve, të lëshuar nga administratori i subjektit minerar R. B.. Pas këtyre veprimeve, prokuroria, më datë {\*\*\*}, ka vendosur sërish pushimin e procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Z. E. Sh., djali i njërit prej viktimave, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke pretenduar se prokuroria e mbylli çështjen duke u mbështetur në akte, si: procesverbalet e udhëzimeve teknike dhe dokumente të tjera, të fabrikuara nga subjekti minerar, me qëllim që t’i shmangej ndjekjes penale dhe se asnjëherë nuk është administruar dokumentacioni përkatës, si thirrjet telefonike, të cilat tregonin se viktimat ishin kontaktuar me telefon nga administratori i shoqërisë, duke i urdhëruar që të paraqitej në punë, pikërisht në ditën e aksidentit.

70. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në vendimin nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, ka arsyetuar se *vendimi i prokurorisë për pushimin e çështjes nuk është marrë si rezultat i një hetimit të plotë e të gjithanshëm e për këtë arsye duhet të shfuqizohet, duke u detyruar prokuroria të vazhdojë hetimet. Prokuroria duhet të kishte sekuestruar procesverbalin origjinal të instruktimit teknik të datës {\*\*\*}, i cili duhet t’i nënshtrohej ekspertimit grafik, dhe jo fotokopja e tij, siç ka vepruar prokuroria Dibër. Edhe pse detyra e mësipërme i ishte ngarkuar nga prokuroria e Përgjithshme, prokuroria e Dibrës nuk e zbatoi këtë detyrë. Prokuroria duhet të identifikojë dhe të administrojë dokumentacionin origjinal dhe të mbështesë vendimet e saj vetëm mbi shkresat origjinale. Baza për dhënien e vendimit për mbylljen e hetimeve ka qenë një akt ekspertimi teknik, sipas të cilit aksidenti ndodhi për faj të viktimave, pasi ata kanë hyrë në vendin e aksidentit pa pasur ndonjë udhëzim për një gjë të tillë. Ky përfundim u mor si i mirëqenë nga prokuroria, duke e përdorur atë si bazë për arsyetimin e vendimit, për mbylljen e çështjes, por të tilla përfundime nuk mbështeten në prova, pasi aktet e referuara nga akti i ekspertimit ishin fotokopje dhe jo origjinale. Prokuroria duhet të bënte verifikime pranë subjektit privat “{\*\*\*}”, nëse dokumentet pjesë e hetimit ishin lëshuar realisht nga ky subjekt.*

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, vendosi të linte në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Ky vendim ka marrë formë të prerë<sup>39</sup>.

71. Nga situata faktike e analizuar si më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar asnjë ankim administrativ apo ankim ligjor, deri më datë {\*\*\*}, kohë në të cilën ai ka qenë ende në detyrën e drejtuesit të prokurorisë, rezulton i pabazuar në rrethanat e përshkruara në vendimin nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, sipas të cilit vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal është kundërshtuar në Prokurorinë e Përgjithshme nga djali i njërit prej viktimave, në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë ende në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër.
72. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se edhe pas shfuqizimit të këtij vendimi nga Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së detyrave të lëna nga ky organ, procedimi penal është pushuar përsëri nga një prokuror tjetër dhe vendimi i ri i pushimit nuk është shfuqizuar nga drejtuesja e prokurorisë në atë kohë, e cila aktualisht është konfirmuar nga Komisioni në detyrën e prokurores, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të shërbejë si argument për të justifikuar moskryerjen e veprimeve të duhura prej tij, në zbatim të ligjit procedural, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë.  
Bazuar në sa më sipër, si dhe në mbështetje të arsytimit të bërë në paragrafin 63 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Për pasojë, trupi gjykues gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit në lidhje me këtë procedim penal dhe të pabazuar shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit.
73. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është i arsyetuar, duke përfshirë të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e çështjes bazuar në prova dhe ligj*, trupi gjykues vëren se në lidhje me këtë çështje, Komisioni në vendim<sup>40</sup>, ka arritur në konkluzionin se: *[...] vendimi i mosfillimit mbi këtë çështje nuk përmban një shkak sipas parashikimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara; arsyetimi i tij rezulton të jetë i pabazuar dhe jo bindës; evidentohet moskryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore, të nevojshme, mbi faktet dhe rrethanat e ngjarjes objekt hetimi. Nisur nga këto konstatime, si dhe duke pasur në konsideratë informacionet konfidenciale të marra nga organet ligjzbatuese për favorizim të personit nën hetim nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje, trupi gjykues çmon se veprimet dhe mosveprimet e subjektit, si dhe vendimmarrja e tij, kanë cenuar besimin e publikut ndaj figurës së prokurorit/magjistratit dhe, rrjedhimisht, ndaj sistemit të drejtësisë në Shqipëri.*
74. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur se prokuroria, pasi ka administruar aktet e ekspertimit mjeko-ligjor, aktin e ekspertimit tekniko-minerar, pyetjen e personave që tregojnë rrethana të dobishme hetimi, si dhe duke administruar në tërësi materialin dhe aktet procedurale, ka konstatuar se nuk ka rezultuar asnjë e dhënë apo fakt për elemente të ndonjë vepre penale dhe, për këtë arsye,

<sup>39</sup> Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.05.2019, ka informuar ONM-në se aktualisht për këtë çështje janë duke u kryer hetime.

<sup>40</sup> Paragrafi 148 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues në fjalë, sipas nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti se vendimi për mosfillimin e procedimit penal rezulton të jetë miratuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe nuk është ankimuar në gjykatë nga palët e interesuara, dëshmon për një vendimmarrje të drejtë nga ana e tij.

75. Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konkretisht dosjes penale të kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, rezulton se nga Komisariati i Policisë Bulqizë, më datë {\*\*\*}, është përcjellë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër material kallëzues në lidhje me ngjarjen e ndodhur më datë {\*\*\*}, ku në një nga galeritë e subjektit minerar “{\*\*\*}” ShPK, është aksidentuar shtetasi F. Z.. Fillimisht ky shtetas ka marrë mjekim në spitalin e Bulqizës, nga ku më pas është dërguar në spitalin e traumës në Tiranë, për trajtim më të specializuar. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor, datë {\*\*\*}, i kërkuar nga policia gjyqësore, rezulton se dëmtimet e shkaktuara hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të rënda, pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shaktimit, po të mos jepej ndihma e shpejtë. Sipas aktit të ekspertimit tekniko-minerar, shkak i aksidentit ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë në punë nga i aksidentuari, për pasojë përgjegjësia është e vetë të dëmtuarit.
76. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues në fjalë, sipas nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pasi janë kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe janë administruar akti i ekspertimit mjeko-ligjor, akti i ekspertimit tekniko-minerar, nga të cilat nuk ka rezultuar asnjë e dhënë apo fakt për ekzistencën e elementeve të ndonjë vepre penale, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi nga verifikimi i akteve të dosjes së kallëzimit penal, rezulton se nuk është administruar kontrata e punës ndërmjet personit të dëmtuar F. Z. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Bulqizë, në mënyrë që të vërtetohej marrëdhënia e punës mes të aksidentuarit dhe subjektit minerar; punonjësi i aksidentuar, megjithëse është identifikuar si fajtor për aksidentin, nuk është marrë asnjëherë në pyetje; nuk është marrë në pyetje asnjë administrator i subjektit minerar; sipas aktit të ekspertimit tekniko-minerar, zona ku ka ndodhur aksidenti është brenda fushës së mbulimit të licencës së kompanisë, por vetë licenca nuk është administruar nga prokuroria, si dhe nuk janë administruar licencat e ekspertëve që kanë kryer aktin e ekspertimit tekniko-minerar. Sipas aktit të ekspertimit tekniko-minerar, datë {\*\*\*}, shkak i aksidentit ka qenë pakujdesia e punonjësit, por ky konkluzion nuk përputhet me deklaratimet e personave që tregojnë rrethana të dobishme për qëllime të hetimit, pasi dy punonjësit e pranishëm në momentin e aksidentit janë marrë në pyetje dhe, sipas deklaratave të tyre, i dëmtuari po kryente thjesht detyrat e tij sipas udhëzimeve, nën mbikëqyrjen e supervisorit, i cili nuk ndërhyri për t'i treguar të dëmtuarit se po bënte gabim, madje nuk tregojnë ndonjë veprim të pamatur të tij, të kryer me iniciativën e vet. Në këto kushte, nuk është sqaruar se si i dëmtuari ka nënvlerësuar rrezikun dhe çfarë veprimesh konkretisht ka ndërmarrë ai me iniciativën e vet, si pasojë e të cilave ka ndodhur aksidenti. Për sa më sipër, vendimi i subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal, rezulton të jetë bazuar në rrethana të vërtetuara pjesërisht, të cilat nuk mund të japin një konkluzion të saktë lidhur me ekzistencën e elementeve të veprës penale.
77. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi për mosfillimin e procedimit penal rezulton të jetë miratuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe, për këtë arsye, është i bazuar në ligj e në prova, trupi gjykues vëren se neni 25 i Kodit të Procedurës Penale të kohës, dhe urdhri nr. 147, datë 09.05.2008, i Prokurorit të Përgjithshëm rregullojnë mënyrën e kontrollit dhe marrjes së vendimeve nga prokurorët më të lartë, me synim unifikimin e mënyrës së ushtrimit të funksioneve

në prokurori, por nuk parashikojnë zhveshjen nga përgjegjësia të prokurorëve të çështjes në marrjen e vendimeve prej tyre, përkundrazi saktësojnë pikërisht ndarjen e përgjegjësive dhe përcaktojnë mjetet ligjore për të siguruar pavarësinë e prokurorit të çështjes në vendimmarrje prej autoritetit të drejtuesit të prokurorisë, si prokuror më i lartë. Për këtë arsye, miratimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal nga drejtuesi i prokurorisë, nuk do të thotë *apriori* se ky vendim është i drejtë dhe njëkohësisht nuk shmang përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes.

78. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, si dhe duke mbajtur në konsideratë arsyetimin e bërë në paragrafin 63 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arrin në përfundimin se, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe arsyetimi i subjektit të rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësimin të pjesës arsyetuese të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016<sup>41</sup>. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se edhe ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.
79. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është marrë mbi bazën e rrethanave dhe verifikimeve të plota, si dhe administrimit të të gjitha provave*, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim<sup>42</sup>, ka arritur në konkluzionin se: *Komisioni, edhe në këtë rast, konstaton: (i) mungesën e kryerjes së hetimeve të plota dhe gjithëpërfshirëse; (ii) hetime të nxituara pa kryer të gjitha hapat hetimore (të planifikuar dhe urdhëruar); si dhe (iii) pagabueshmërinë e vendimmarrjes për mosfillim të procedimit penal, për shkak të mosadministrimit në dosje të aktit të ekspertimit ndaj të dëmtuarit E. H., në mospërfillje të vendimit, datë {\*\*\*}, (i) parevokuar/shfuqizuar) të vetë prokurorisë në fjalë, me të cilin ishte caktuar eksperti, duke i kërkuar kryerjen e ekspertimit mbi dëmtimet e këtij shtetasi. Trupi gjykues çmon se mangësitë e konstatuara në hetimin e kësaj çështjeje, për të cilën gjithashtu ka pasur informacione të klasifikuara, në çdo rast përbëjnë në vetvete shkak për humbjen e besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë.*
80. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është nxjerrë jo mbi bazën e një deklaratë të thjeshtë, siç pretendon Komisioni. Të gjitha shpjegimet në lidhje me ngjarjen e ndodhur janë dhënë nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes, duke sqaruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, lidhjen shkakësore dhe pasojën e ardhur. Mosadministrimi i aktit të ekspertimit tekniko-minerar nuk ka ndikuar në zgjidhjen ligjore të çështjes. Sipas subjektit të rivlerësimit, neni 289 i Kodit Penal kërkon ardhjen e një pasoje të caktuar, vdekjen ose dëmtimin e rëndë të shëndetit, në të kundërt figura e veprës penale konsiderohet jo e plotë në të gjitha elementet e saj. Në rastin konkret, pasoja e kërkuar nuk ka ardhur pasi dëmtimet që kanë pësuar të dëmtuarit hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të lehta e, në

<sup>41</sup> Neni 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 parashikon: “3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit”.

<sup>42</sup> Paragrafi 157 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

këto rrethana, është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Vendimi në fjalë është miratuar nga drejtuesi i prokurorisë, u është njoftuar palëve dhe nuk rezulton të jetë ushtruar ankim prej tyre.

81. Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konkretisht dosjes penale të kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, rezulton se:

Më datë {\*\*\*}, Komisariati i Policisë Bulqizë u njoftua se shtetasit B. P. dhe E. H., punonjës të subjektit minerar “{\*\*\*}” ShPK, ishin dëmtuar në vendin e punës.

Kallëzimi penal i është referuar Prokurorisë së Rrethit Dibër, më datë {\*\*\*}.

Policia Gjyqësore, në referim të kallëzimit penal, ka dorëzuar në prokurori këto dokumente: informacion referimi për veprën penale; procesverbal këqyrje i vendit të ngjarjes; vendimet që urdhërojnë kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore dhe ekspertimin tekniko-minerar; procesverbale deklarimi të personave që kanë njohuri për veprën penale, si dhe provat materiale: udhëzuesin periodik të punonjësve; urdhrat dhe programet e punës; lejen zhvillimore; raportin mjeko-ligjor vetëm për njërin nga personat e dëmtuar.

Sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, shtetasi B. P. i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në këmbë dhe dëmtimet e shkaktuara në trupin e tij hyjnë në kategorinë e dëmtimeve që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë për më shumë se 9 ditë.

Lidhur me personin tjetër të dëmtuar, rezulton shënimi se ai nuk u paraqit dhe as nuk u mor në pyetje, pasi nuk shihej e nevojshme.

Më datë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar vendimin për mosfillimin e procedimit penal në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale, duke arsyetuar se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor dhe nuk shihet ndonjë shkelje apo nënvlerësim i rregulloreve nga drejtuesit e subjektit minerar.

82. Trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, duke vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë prej tij jo vetëm mbi bazën e shpjegimeve në lidhje me ngjarjen e ndodhur, të dhëna nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes dhe se mosadministrimi i aktit të ekspertimit tekniko-minerar nuk ka ndikuar në zgjidhjen ligjore të çështjes. Trupi gjykues konstaton se nga policia gjyqësore është marrë vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit tekniko-minerar<sup>43</sup>, por ai nuk është administruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes. Në vendimin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal, nuk ka asnjë arsyetim se përse nuk ishte i nevojshëm administrimi i aktit të ekspertimit tekniko-minerar dhe si ka arritur ai në përfundimin se aksidenti ka ndodhur si pasojë e papërgjegjshmërisë së personave të dëmtuar. Gjithashtu, ai nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë veprimet e papërgjegjshme të punonjësve që shkaktuan si pasojë aksidentin, ashtu siç është analizuar në paragrafin 63 më sipër në këtë vendim. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi është bazuar në shpjegimet e dhëna në lidhje me ngjarjen e ndodhur nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes, por punonjësit e marrë në pyetje nga policia gjyqësore nuk kanë deklaruar se aksidenti ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së personit të dëmtuar. Për më tepër, shtetasi B. P., si person i dëmtuar, nuk është marrë asnjëherë në pyetje.

---

<sup>43</sup> Sipas vendimit të oficerit të policisë gjyqësore, datë {\*\*\*}, për kryerjen e ekspertimit tekniko-minerar, akti i ekspertimit duhej t'u përgjigjej pyetjeve nëse janë marrë masat teknike të sigurisë nga subjekti minerar për sigurimin e kushteve teknike në lidhje me shkatërrimin e objekteve në vendin e aksidentit; nëse ka ndonjë shkelje të rregullave të sigurisë teknike në këtë ngjarje specifike dhe nëse po, cilat rregulla dhe nga kush; shkaqet e ndodhjes së aksidentit dhe përgjegjësia përkatëse.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor, por nuk ka arsyetuar mbi cilat prova e ka arritur këtë përfundim. Në vendim, ai është shprehur se: *Referuar veprimeve hetimore të kryera nga ana e policisë gjyqësore, deklarimeve të shtetasve të pyetur, me detyra funksionale në subjektin minerar, akt ekspertimi mjeko-ligjor etj., rezulton se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor dhe nuk shohim ndonjë shkelje apo nënvlerësim të rregullores nga drejtuesit e subjektit apo zëvendësit e tij.* Aktet e cituara në vendim nga subjekti i rivlerësimit, nuk referojnë në asnjë rast se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal nuk është arsyetuar mjaftueshëm dhe qartë, si dhe nuk rezulton të jenë përshkruar rrethanat faktike mbi dinamikën e ngjarjes, provat mbi të cilat mbështetë vendimi i mosfillimit dhe analiza e tyre.

83. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, në rastin konkret, nuk ka ardhur pasoja e kërkuar nga neni 289 i Kodit Penal, pasi dëmtimet që ka pësuar i dëmtuari, hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të lehta e, në këto rrethana, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, trupi gjykues vëren se ky arsytim nuk është bërë nga subjekti i rivlerësimit në vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Përkundrazi, në këtë vendim, baza e arsytimit është përfundimi se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor dhe nuk ka shkelje të rregullave të sigurisë në punë nga drejtuesit e subjektit minerar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.
84. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, trupi gjykues arrin në përfundimin se në kuadër të aspektit të arsytimit ligjor, subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësisë të pjesës arsytuese të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.
85. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është marrë mbi bazën e një arsytimi të plotë të rrethanave të ngjarjes, akteve shkresore të administruara në fashikull, duke qenë i bazuar në prova dhe ligj, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim<sup>44</sup>, ka arritur në konkluzionin se: [...] vendimi i mosfillimit mbi këtë çështje nuk përmban një shkak, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara; arsytimi i tij rezulton të jetë i pabazuar dhe jo bindës; evidentohet moskryerja e veprimeve hetimore, të domosdoshme, mbi faktet dhe rrethanat e ngjarjes objekt hetimi si, mungesa e ekspertizës teknike mbi shkaqet e aksidentit plagosës. Këto konkluzione, të ngjashme me ato të arritura mbi çështjet e tjera të analizuara më lart, evidentojnë disa mangësi profesionale kronike të subjektit të rivlerësimit, përgjatë hetimeve të kryera prej tij, lidhur me përgjegjësitë penale për mungesën e sigurisë teknike në punë, pra galerive të minierës së Bulqizës, si dhe një modus operandi sipërfaqësore dhe të papërshtatshme me funksionin e tij, nga momenti që rezulton në mënyrë të përsëritur dhe konstante mospërmbushja e detyrave (hetimeve) prej tij, në mënyrën e duhur, qoftë në funksionin e prokurorit, po ashtu edhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë. Nga ana tjetër, trupi gjykues çmon se dyshimet dhe informacionet e klasifikuara, të njohura nga trupi gjykues, që referojnë edhe mbi favorizimeve që subjekti i rivlerësimit ka kryer në favor të personave nën hetim, pikërisht për këto lloje çështjesh të hetuara prej tij, përforcojnë bindjen se veprimet dhe mosveprimet gjatë procesit të hetimit, si dhe kjo vendimmarrje e subjektit, kanë cenuar besimin e publikut ndaj figurës së prokurorit dhe, rrjedhimisht, ndaj sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

<sup>44</sup> Paragrafi 164 i vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.



86. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është nxjerrë jo mbi thënie, siç pretendon Komisioni, por mbi prova dhe akte të pakontestueshme të administruara në fashikullin penal. Të gjitha shpjegimet në lidhje me ngjarjen e ndodhur, janë dhënë nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes, duke sqaruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, lidhjen shkakësore dhe pasojën e ardhur. Mosadministrimi i aktit të ekspertimit tekniko-minerar nuk ka ndikuar në zgjidhjen ligjore të çështjes. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi ka krijuar bindjen e arsyeshme se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të regjistruar procedimin penal. Neni 289 i Kodit Penal kërkon ardhjen e një pasoje të caktuar, vdekjen ose dëmtimin e rëndë të shëndetit, në të kundërt figura e veprës penale konsiderohet jo e plotë në të gjitha elementet e saj. Në rastin konkret, pasoja e kërkuar nuk ka ardhur pasi dëmtimet që kanë pësuar të dëmtuarit hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të lehta, e në këto rrethana është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Sipas subjektit të rivlerësimit, në kohën e vendimmarrjes, nuk ka pasur akt ekspertimi tekniko-minerar, akt i cili është administruar nga drejtuesi i prokurorisë dy muaj më vonë, ku është shprehur se nuk ka pasur shkelje të rregullave të sigurimit teknik dhe në këtë aksident nuk ka asnjë person përgjegjës. Vendimi në fjalë është miratuar nga drejtuesi i prokurorisë.
87. Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konkretisht dosjes penale të kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, rezulton se më datë {\*\*\*}, shtetasja M. I., punonjëse pranë subjektit minerar “{\*\*\*}” ShPK, është dëmtuar në punë. Komisariati i Policisë Bulqizë ka bërë referimin e veprës penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Bulqizë, më datë {\*\*\*}. Në datën {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur mosfillim të procedimit penal në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale.
88. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është nxjerrë jo mbi thënie, siç pretendon Komisioni, por mbi prova dhe akte të pakontestueshme të administruara në dosje dhe se mosadministrimi i aktit të ekspertimit tekniko-minerar nuk ka ndikuar në zgjidhjen ligjore të çështjes, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit për mosfillimin e procedimit penal, si dhe akteve të administruara në dosjen penale, trupi gjyqësor vëren se në momentin e vendimmarrjes nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton të jetë administruar asnjë akt ekspertimi teknik për sigurinë në vendin e punës ku ndodhi aksidenti, megjithëse kishte një vendim të policisë gjyqësore të datës {\*\*\*}<sup>45</sup>, për kryerjen e tij. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal, pa pritur ardhjen e aktit të ekspertimit të kërkuar nga policia gjyqësore.
- Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, subjekti i rivlerësimit shprehet se nga prokuroria është marrë një vendim për kryerjen e ekspertizës teknike, por sipas informacionit të administratorit të subjektit minerar “{\*\*\*}” ShPK, në mjediset e të cilit kishte ndodhur aksidenti, ekspertët e RISHM-së<sup>46</sup> nuk kryejnë ekspertiza për raste të lehta. Subjekti i rivlerësimit nuk ka administruar asnjë shkresë zyrtare të lëshuar nga RISHM-ja, në të cilën të deklarohet një gjë e tillë.

---

<sup>45</sup> Sipas vendimit të policisë gjyqësore të datës {\*\*\*}, akti i ekspertimit duhej t’u përgjigjej disa pyetjeve në funksion të hetimit të ngjarjes, si: 1. Nëse vendi i aksidentit përfshihet në objektin e licencës së shoqërisë? 2. Cilat janë masat e marra teknike nga subjekti minerar për sigurimin e kushteve teknike? 3. Nëse ka ndonjë shkelje të rregullave të sigurisë teknike në ngjarjen konkrete dhe cilat janë rregullat e shkelura nëse ka të tilla? 4. Cilat janë shkaqet e ndodhjes së aksidentit dhe cilat janë përgjegjësitë në ardhjen e tij? 5. Nëse ka përgjegjësi zotëruesi i lejes minerare dhe cila është ajo?

<sup>46</sup> Reparti i Inspektimit dhe Shpëtimit të Minerave.

Për pasojë, vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit për të vijuar me mosfillimin e procedimit penal, pa pritur aktin e ekspertimit tekniko-minerar, nuk rezulton të jetë i bazuar në ligj, por vetëm në thëniet e administratorit të shoqërisë, të cilat përveçse janë thënie të një personi i cili mund të kishte një përgjegjësi të mundshme në çështjen konkrete, janë kundërshtuar edhe nga faktet, pasi në dosjen penale është administruar një akt ekspertimi teknik që mban datën {\*\*\*}, rreth dy muaj pasi subjekti i rivlerësimit kishte vendosur për mosfillimin e procedimit penal. Gjithashtu, rezulton se shtetasja e plagosur M. I. nuk është marrë asnjëherë në pyetje. Ndërkohë që vendimi i mosfillimit i është njoftuar asaj vetëm në datën {\*\*\*}, rreth tre muaj pas marrjes së vendimit, dhe dy ditë pas mbërritjes në prokurori të aktit të ekspertimit tekniko-minerar, i cili nuk është marrë në konsideratë në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimmarrja e tij është bazuar në prova e akte të pakontestueshme, nuk përputhet me arsyetimin e bërë prej tij në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, në të cilin nuk janë argumentuar rrethanat e faktit si ka ndodhur ngjarja, provat që mbështesin konkluzionin e arritur dhe nuk është kryer një analizë e tyre, sipas arsyetimit të bërë në paragrafin 63 më sipër në këtë vendim. Në vendim nuk është arsyetuar mbi ekzistencën e asnjë prej kushteve të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit duhet të ekzistojnë qartësisht rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.

89. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, trupi gjykues arrin në përfundimin se, në kuadër të aspektit të arsyetimit ligjor, subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësisht të pjesës arsyetuese të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.
90. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vendimi për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, është marrë pas krijimit të bindjes së arsyeshme të bazuar në prova se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të regjistruar procedimin penal*, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim<sup>47</sup>, ka arritur në konkluzionin se: *Vendimi i analizuar mbi mosfillimin e procedimit penal nuk është i arsyetuar dhe nuk përfshin të gjitha elementet dhe përmbajtjen e një vendimi që zgjidh çështjen. Nuk janë argumentuar rrethanat e faktit si ka ndodhur ngjarja, provat që mbështesin konkluzionin e arritur nga subjekti dhe nuk është kryer një analizë e provave. [...] Subjekti ka vendosur duke u bazuar në rrethana të paverifikuara nga ekspertiza teknike në terren dhe pa u kryer më parë një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, që do të çonte në nxjerrjen e një përfundimi më të saktë në lidhje me ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale të dyshuar. Subjekti nuk ka pritur kryerjen dhe administrimin e aktit të ekspertimit teknik, ndonëse ky veprim hetimor ishte urdhëruar nga vetë prokuroria. Subjekti nuk ka evidentuar/përshkruar ekzistencën e asnjë prej kushteve të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, duhet të ekzistojnë qartësisht rrethanat që nuk lejojnë nisjen e procedimit penal. Në këtë rast, nuk rezulton të ketë apo të jenë cituar nga subjekti rrethana të tilla.*
91. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është bazuar në shpjegimet në lidhje me ngjarjen e ndodhur, të dhëna nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes, duke sqaruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, lidhjen shkakësore dhe pasojën e ardhur. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi ka krijuar bindjen

---

<sup>47</sup> Paragrafët 172-176 të vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit.

e arsyeshme se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të regjistruar procedimin penal. Në rastin konkret, pasoja e kërkuar nga neni 289 i Kodit Penal – vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit – nuk ka ardhur, pasi dëmtimet që ka pësuar i dëmtuari hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të lehta e, në këto rrethana, është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Vendimi në fjalë u është njoftuar palëve dhe nuk rezulton të jetë ushtruar ankim prej tyre.

92. Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konkretisht dosjes penale të kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, datë {\*\*\*}, rezulton se:

Më datë {\*\*\*}, nga Komisioni i Policisë Bulqizë është referuar në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Bulqizë, se shtetasi R. H., me detyrë armator pranë subjektit minerar “{\*\*\*}” ShPK, më datë {\*\*\*}, ishte plagosur në punë. Nga aktet e dërguara pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton se oficeri i policisë gjyqësore ka marrë vendim për kryerjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor dhe aktit të ekspertimit tekniko-minerar, si dhe janë pyetur persona që kanë dijeni për veprën penale. Më datë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillim e procedimit penal, në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale.

93. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë bazuar në shpjegimet në lidhje me ngjarjen e ndodhur, të dhëna nga personat e pranishëm në vendin e ngjarjes, duke sqaruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, lidhjen shkakësore dhe pasojën e ardhur, trupi gjykues, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit për mosfillimin e procedimit penal, si dhe nga aktet e administruara në dosjen penale, konstatoi se konkluzioni i subjektit të rivlerësimit në vendim, se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor dhe nuk ka shkelje të rregullores nga drejtuesit e subjektit minerar, nuk mbështetet në arsyetim mbi prova konkrete, por në pohimin e thjeshtë të personave të pyetur, kolegëve të të dëmtuarit dhe administratorit e drejtuesit teknik të subjektit minerar. Por, në ndryshim nga sa ka argumentuar subjekti i rivlerësimit në vendim, shumica e personave të marrë në pyetje janë shprehur se kanë arritur në vendin e ngjarjes pasi kishte ndodhur aksidenti, duke e gjetur tashmë të dëmtuar punonjës R.H.. Ndërsa supervizori dhe kolegët e tij pohojnë se armatori R.H., në momentin e aksidentit, ishte duke vepruar sipas urdhrat të supervizorit dhe udhëzimeve që i ishin dhënë për punën që duhet të kryente.

Akti i ekspertimit tekniko-minerar, kryerja e të cilit është kërkuar sipas vendimit të datës {\*\*\*}<sup>48</sup> të oficerit të policisë gjyqësore, nuk është administruar asnjëherë dhe as nuk është arsyetuar në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, pse nuk u pa i nevojshëm administrimi i tij. Nuk është administruar kontrata e punësimit të personit të dëmtuar me subjektin minerar. Vetë personi i dëmtuar, megjithëse është arritur në përfundimin se ka qenë përgjegjës për aksidentin e ndodhur, nuk është pyetur asnjëherë

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë nga verifikimet e duhura, sipas analizës së bërë në paragrafin 63 të këtij vendimi, në lidhje me rregullat e sigurisë teknike në punë dhe njohjen e formimit e punonjësve në lidhje me to.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se vendimi i mosfillimit të procedimit penal, marrë nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton të jetë arsyetuar mjaftueshëm, pa u administruar provat e

---

<sup>48</sup> Akti i ekspertimit tekniko-minerar duhet t'u përgjigjej pyetjeve: 1. Nëse vendi i aksidentit është brenda fushës së licencimit së kompanisë? 2. Cilat janë masat e sigurisë teknike të ndërmarra nga subjekti minerar? 3. Nëse ka shkelje të rregullave të sigurisë teknike në ngjarjen e ndodhur, e nëse po cilat janë ato? 4. Cilat janë shkaqet e aksidentit dhe cilat janë përgjegjësitë në ardhjen e këtij aksidenti? 5. Nëse zotëruesi i lejes minerare ka ndonjë përgjegjësi dhe cila është ajo?

kërkuara dhe pa u analizuar rrethanat që do të rezultinin prej tyre. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

94. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se neni 289 i Kodit Penal kërkon ardhjen e një pasoje të caktuar, vdekjen ose dëmtimin e rëndë të shëndetit, në të kundërt figura e veprës penale konsiderohet jo e plotë në të gjitha elementet e saj dhe, në rastin konkret, pasoja e kërkuar nuk ka ardhur pasi dëmtimet që kanë pësuar të dëmtuarit hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të lehta, e në këto rrethana është vendosur mosfillimi i procedimit penal, trupi gjykues vëren se ky arsyetim nuk është bërë nga subjekti i rivlerësimit në vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Subjekti është mjaftuar vetëm me citimin në arsyetim të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, por pa elaboruar dhe vlerësuar më tej nëse, bazuar në këtë akt ekspertimi, plotësoheshin elementet e veprës penale të parashikuar në nenin 289 të Kodit Penal. Në këtë vendim konstatohet se baza e arsyetimit është përfundimi se aksidenti ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor dhe nuk ka shkelje të rregullave të sigurisë në punë nga drejtuesit e subjektit minerar.
95. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*} të vitit {\*\*\*}, trupi gjykues arrin në përfundimin se, në kuadër të aspektit të arsyetimit ligjor, subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësisë të pjesës arsyetuese të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.
96. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, trupi gjykues vëren se çështjet penale të trajtuara e në të cilat janë evidentuar problematika në drejtim të arsyetimit ligjor dhe njohurive ligjore të subjektit të rivlerësimit, lidhen me hetimin e veprave penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal ose mosfillimin e procedimit penal, duke përcaktuar se përgjegjësia për aksidentet e ndodhura në ambientet e punës në minierat e Bulqizës, ka qenë në të gjitha rastet e viktimave të aksidenteve, duke shmangur nga hetimi dhe përgjegjësia e mundshme subjektet minerare.
97. Punëmarrësit e dëmtuar apo viktimat janë konsideruar fajtorë për ndodhjen e aksidenteve pa u kryer verifikime/hetime të plota. Punonjësit e minierave kanë rezultuar pala më e dobët në marrëdhëniet e punës, por edhe në procedimet penale, pasi subjekti i rivlerësimit me vetëdije, duke ditur njohuritë e kufizuara të tyre dhe pamundësinë financiare për të ndjekur rrugën ligjore për të ankimuar çështjen, nuk ka hetuar mbi ekzistencën e kontratave të punës, kushtet e sigurisë teknike dhe shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi, dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit përkatës penal, pa pritur ardhjen e aktit të ekspertimit tekniko-minerar, duke vepruar në kundërshtim me misionin e organit të akuzës, për të zbuluar të vërtetën mbi aksidentet e ndodhura dhe ngritjen e një akuze të bazuar në fakte, prova dhe ligj, për të vënë para përgjegjësisë shkelësit e ligjit. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në një analizë sipërfaqësore të fakteve, kryesisht të rezultuara vetëm nga veprimet e para hetimore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore, ka arritur në konkluzione të njëjta, duke fajësuar viktimat apo punonjësit e dëmtuar si shkelës të rregullave të sigurimit teknik, veprime këto që konsiderohen nga trupi gjykues me ndikim në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e trupit gjykues, gjykimi dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në këto çështje të shqyrtuara konsiderohet se ka rrezikuar apo

cenuar të drejtat e qytetarëve, duke rënë ndesh me parashikimet e nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016<sup>49</sup>.

*Dh. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*

98. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *në asnjë rresht të vendimit, Komisioni nuk ka arsyetuar se cila është ajo shkelje e cila ngrihet në nivelin e dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por vetëm ka bërë citimin formal të dispozitës, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit*, trupi gjykues, nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, konstaton se në përfundim të çdo analize për secilën dosje penale për veprën penale “Shkelje e rregullave të sigurisë teknike në punë”, Komisioni ka arritur në konkluzione konkrete sipas të cilave vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Ndërsa në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni ka vlerësuar si shkaqe të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si vijon: *[...] deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme në ILDKPKI; mosdeklarimin i shkëmbimit të apartamentit; dyshime të arsyeshme mbi integritetin e figurës, të ngritura nga organet ligjzbatuese dhe të konfirmuara nga informacionet me të cilat janë njohur anëtarët e trupit gjykues; mangësitë profesionale të përsëritura dhe dyshime të arsyeshme mbi favorizime të personave nën hetim, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut në figurën e prokurorit dhe, më gjerësisht, në sistemin e drejtësisë, dhe për rrjedhojë në rastin konkret duhet të aplikohet edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

Nga sa më sipër, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në lidhje me shkaqet të cilat përbëjnë cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë e që, për pasojë, sipas vlerësimit të Komisionit, kanë sjellë aplikimin në mënyrë autonome të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

99. Në lidhje me pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, sipas paragrafit 6.25 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson si vijon.

Në lidhje me pretendimin se *në asnjë rresht të vendimit të Komisionit nuk është arsyetuar se ku qëndrojnë shkeljet e etikës nga ana e subjektit të rivlerësimit*, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore për shkelje të etikës.

Në lidhje me pretendimin se *është vlerësuar se ka cenim të besimit të publikut edhe për procedime penale për të cilat është vendosur dërgimi për gjykim, ashtu edhe për ato për të cilat është kërkuar pushimi ose mosfillimi i procedimit penal*, trupi gjykues vëren se ky pretendim nuk mbështetet në të dhënat që rezultojnë nga dosjet penale të shqyrtuara nga Komisioni, pasi në çështjet penale për veprën penale “Shkelje e rregullave të sigurisë teknike në punë”, të shqyrtuara nga Komisioni, nuk rezulton asnjë rast që subjekti i rivlerësimit të ketë dërguar çështjen për gjykim, por bëhet fjalë për vendimmarrje të tij për pushim procedimi penal ose mosfillim procedimi penal.

Në lidhje me pretendimin se *janë shfuqizuar vetëm dy dosje në nivel hierarkik në një hark kohor prej 11 vjetësh dhe, bazuar në parimin e proporcionalitetit, ky fakt nuk mund të përbëjë shkak për të përligjur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra*, trupi gjykues vëren se shkaku i pretenduar

---

<sup>49</sup> Neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 parashikon: “4. Paanësia e magistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi”.

nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të jetë një nga shkaqet për të cilat Komisioni ka vendosur aplikimin e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pretendimin se *nuk ka pasur asnjë rast shfuqizimi vendimi, procedimi apo mosfillim procedimi, qoftë nga drejtuesit qoftë nga gjykata, në bazë të ankimit të ndonjë prej palëve*, trupi gjykues vëren se ky është një pretendim i përsëritur i subjektit të rivlerësimit, i cili është analizuar më sipër në këtë vendim dhe për të cilin trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim.

Në lidhje me pretendimin se *gjykatat, si i vetmi organ që u është njohur tagri i dhënies së drejtësisë, e kanë gjetur vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit si të bazuar në ligj e në prova, në lidhje me procedimet penale që ka pasur vendime shfuqizimi në nivel hierarkik*, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi në gjashtë çështjet e shqyrtuara dhe analizuar nga Komisioni, për të cilat ai ka arritur në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, vetëm njëra prej tyre ka arritur të shkojë në gjykatë dhe kjo e fundit ka vendosur rrëzimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes dhe vijimin e hetimeve. Pesë prej çështjeve nuk kanë arritur të shkojnë në gjykatë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka dërguar çështjen për gjykim dhe nuk ka pasur as ankim nga palët.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

100. Pavarësisht arsytimit të mësipërm, trupi gjykues, lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, vëren se të gjitha çështjet e analizuar në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, të cilat janë konsideruar prej Komisionit si shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, janë vlerësuar po ashtu prej tij se përbëjnë bazë për të konkluduar se subjekti gjendet për të njëjtat shkaqe edhe në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që shkakton vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë renditet si shkak i fundit i shkarkimit në rastet e parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ka në përbërje të saj çdo situatë shkeljesh ligjore të cilat, edhe nën frymën e neneve D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, përfaqësojnë shkelje të ligjit të afta për të shkaktuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në raport me secilin prej kriterëve të rivlerësimit. Konkretisht, neni 61, pikat 1 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e pasurisë, neni 61, pikat 2 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e figurës, dhe neni 61, pika 4 është shkak shkarkimi për kriterin e aftësive profesionale.

Sipas jurisprudencës së Kolegjit, në rast se shkeljet e ligjit për secilin kriter, por edhe vetëm për njërin prej tyre janë tilla, që klasifikojnë situatën sipas asaj që parashikojnë pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61, subjekti do të gjendet para vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në zbatim të parimit të mosndëshkimit dy herë për të njëjtën shkelje, qëndrimi i Komisionit i cili kualifikon dy herë si shkak shkarkimi, për efekt të këtij procesi, të njëjtën shkelje, nuk është i drejtë. Në rastin konkret, Komisioni ka kualifikuar shkeljet e konstatuara në vlerësimin e aftësive profesionale si shkelje të vlefshme edhe për të cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky qëndrim i Komisionit, i cili kualifikon dy herë si shkak shkarkimi, për efekt të këtij procesi, të njëjtën shkelje, nuk është i mbështetur në ligj.

101. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se deklarimet e pasakta dhe të pamjaftueshme në ILDKPKI dhe mosdeklarimi i shkëmbimit të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit përbëjnë shkaqe për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vëren se këto konkluzione lidhen me pasaktësitë në deklarimin para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, në vitin 2006, në ILDKPKI, në lidhje me vlerën e blerjes së pasurisë apartament banimi me

sipërfaqe 78,01 m<sup>2</sup> në qytetin e Burrelit, si dhe me mosdeklarimin e shkëmbimit të kësaj pasurie me apartamentin me sipërfaqe 70,9 m<sup>2</sup> që ai ka aktualisht në pronësi në këtë qytet, në deklaratën e interesave privatë në vitin 2013. Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se, në interpretim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, duhet që të ekzistojnë shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 3 ka përcaktuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Për rrjedhojë, pamjaftueshmëria e deklaramit përfshin edhe deklaramet e pasakta të subjekteve të rivlerësimit në deklaramet periodike të interesave, apo edhe në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, por gjithsesi mbetet një element i cili mund të konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Për pasojë, trupi gjykues çmon se deklaramet e pasakta të subjektit të rivlerësimit për ish-pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 78,01 m<sup>2</sup> në qytetin e Burrelit, mund të ishin përfshirë nga Komisioni në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë dhe të kualifikoheshin sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por nuk mund të kualifikohen për shkarkimin e tij, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

102. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit dyshimet e arsyeshme mbi integritetin e figurës, të ngritura nga organet ligjzbatuese dhe të konfirmuara nga informacionet me të cilat janë njohur anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, përbëjnë shkak për shkarkim nga detyra pasi cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vëren se, në lidhje me kontrollin e kriterit të figurës, Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se: “Nga hetimi administrativ dhe rivlerësimi i kryer nga Komisioni, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, bazuar në provat dhe dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se, në raportin e dërguar nga DSIK-ja, vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të tilla që merren parasysh në konstatimin përfundimtar të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi rrethana të tjera, mbi veprime korruptive të përsëritura, nuk rezultojnë të provuara/bazuara mjaftueshëm, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to”.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i arritur nga Komisioni se dyshimet e arsyeshme mbi integritetin e figurës përbëjnë cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, është i paqartë dhe kontradiktor me arsyetimin e bërë më sipër në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës. Në kushtet kur vetë Komisioni ka arsyetuar se dyshimet e ngritura mbi rrethana të tjera, mbi veprime korruptive të përsëritura, nuk rezultojnë të provuara/bazuara mjaftueshëm, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to, mbetet i paqartë dhe i paarsyetuar konkluzioni i tij mbi cenimin e besimit të publikut, pasi nuk janë sqaruar se cilat janë dyshimet e arsyeshme mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerëson se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke e parashikuar cenimin e besimit të publikut në nivelin e shkeljes disiplinore e cila passjell shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kërkon që cenimi i besimit të publikut të jetë i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, për shkaqe e shkelje konkrete të cilat duhet të arsyetohen qartësisht e plotësisht. Vlerësimi

i cenimit të besimit të publikut te drejtësia, duke u mbështetur në dyshime të paprovuara, nuk është në përputhje me frymën e ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 5 të nenit 4 të tij parashikon se: *5. Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.*

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e renditura nga Komisioni për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nuk mund të kualifikohen sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

103. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimet e mëposhtme.

#### **103.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë, përfshirë dhe apartamentin me sipërfaqe 91,34 m<sup>2</sup> në Tiranë, për krijimin e kursimeve të deklaruara, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera për periudhën 2006-2016, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për shkak të këtij konkluzioni, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga rastet e parashikuara për shkarkimin e tij nga detyra.

**103.2 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit konsiderohet si i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e prokurorit, sipas parashikimit të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi në të gjitha çështjet penale të shqyrtuara në këtë gjykim, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore mbi faktet dhe rrethanat e ngjarjeve objekt hetimi, si dhe nuk ka administruar prova të besueshme, të cilat do të çonin në nxjerrjen e një përfundimi të saktë në lidhje me ekzistencën e elementeve të veprës penale. Vendimmarrjet për pushimin e procedimit penal ose mosfillimin e procedimit penal për këto çështje, rezultojnë me arsyetim të dobët dhe të pambështetur në prova dhe me analizë joobjektive mbi faktet e dinamikës së aksidenteve dhe lidhjes së tyre shkak-pasojë me mungesën e sigurisë teknike në punë, në galeritë e minierave në Bulqizë.

Mangësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në funksionin e prokurorit, po ashtu edhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenet 73, pikat 2 dhe 3 dhe 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për shkak të këtij konkluzioni, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga rastet e parashikuara për shkarkimin e tij nga detyra.

104. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Hysni Vata gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit D dhe pika 4 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga pikat 3 dhe 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 195, datë 09.09.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.



## **PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 195, datë 09.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysni Vata.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.07.2021.

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*